



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë
Bachelor në “Informatikë Ekonomike”
i
Institucionit të Arsimit të Lartë
Universiteti “Luarasi”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Rezarta Shkurti

2. Prof. Asoc. Ezmolda Barolli

Nëntor 2022

Për Programin e studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Luarasi”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Informatikës Ekonomike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Informatikë Ekonomike”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër i MASR Nr. 417, datë 16 Korrik 2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Vendim i Senatit Akademik të Universitetit “Luarasi” Nr. 21, datë 21.05.2018 që miraton formën dhe suplementin e diplomës Bachelor në “Informatikë Ekonomike”
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: (Viti akademik 2021 – 2022)	26 PAE / 14 PAK
18	Numri i studentëve: (2018 – 2022)	223 studentë
19	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës;

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë Ekonomike” është një program studimi me kohë të plotë, që ofrohet në 6 semestra apo 3 vite akademike në gjuhën shqipe. Me përfundimin me sukses të detyrimeve të këtij programi studimi, lëshohet diploma “Bachelor” në “Informatikë Ekonomike” me 180 kredite.


Ky program është licensuar me Urdhër të MASR Nr. 417, datë 16 Korrik 2018. Sipas dokumentit të hapjes UMASR Nr. 417, datë 16.07.2018, programi ka filluar veprimtarinë akademike në vitin akademik 2018-2019.

Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”, ofrohet nga Departamenti i Informatikës Ekonomike, njësi e vendosur në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit të Universitetit Luarasi.

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017”, Universiteti "Luarasi" ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit për herë të parë të programit të studimit, Bachelor në "Informatikë Ekonomike", nëpërmjet shërbimit AMS.

Ky raport u përgatitur nga ana e Grupi të Vlersimit të Jashtëm (GVJ) dhe ka për qëllim vlerësimin e jashtëm në kuadër të akreditimit të këtij programi studimi.

Përgjatë procesit të vlerësimit të jashtëm, GVJ konstatoi se ky program studimi është ofruar në përputhje me prioritetet akademike të institucionit dhe misionin e tij. Ofrimi i programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”, emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e tij janë në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Universiteti Luarasi. Programi ka si objektivi kryesor formues t’u ofrojë studentëve njohuri multidisiplinore për formimin e tyre si specialistë në fushën e informatikës ekonomike. Ky program synon dhënien e një tërësie njohurish në formimin e përgjithshëm teorik në fushën e shkecape të informatikës dhe të ekonomisë. Për realizimin e këtij objektivi, programi ka harmonizuar ndërthurjen e njohurive formuese në fushën e programimit, bazave të të dhënave, rrjetave kompjuterike, algoritmave me njohuritë bazë të kontabilitetit, financës, statistikës, menaxhimit, etj. Në përfundim të studimeve, të diplomuarit në këtë program do të kenë një sërë mundësish punësimi si specialistë ekonomie dhe informatike në biznese të vogla, të mesme e të mëdha apo në institucione publike e organizata të ndryshme.




Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;

Vlerësimi i jashtëm i programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike është përgatitur nga ekspertët Rezarta Shkurti dhe Ezmolda Barolli të kontraktuar nga ASCAL. Për të hartuar Raportin e Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) grupi i ekspertëve u mbështet në një sërë dokumentash që u aksesuan nëpërmjet shërbimit AMS, të cilat ishin të përfshira në Dosjen e Vetëvlerësimit për këtë program studimi, të ofruar nga Universiteti Luarasi. Gjithashtu informacionet dhe të dhënat e nevojshme për hartimin e këtij raporti u plotësuan edhe gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion të ekspertëve gjatë vizitës dy ditore në institucion, si dhe nëpërmjet intervistave të zhvilluara me personelin akademik dhe administrativ si dhe studentët.

Për të bërë vlerësimin e jashtëm të programit grupi i ekspertëve është mbështetur në kriteret e vendosura në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Standardet e Cilësisë të aprovuara në Kodin e Cilësisë, si dhe aktet ligjore e nënligjore përkatëse. Për hartimin e RVJ ekspertët kanë ndjekur një metodologji bazuar tek analizimi i dokumentave dhe përputhja e tyre me kriteret e kërkesat ligjore në lidhje me akreditimin e programeve të studimit të nivelit “Bachelor” në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri. Vlerësimi i programit u përqëndrua në analizën planit mësimor sipas aktiviteteve dhe planit mësimor të detajuar, shpërndarjes së krediteve dhe orëve krahasuar me kërkesat e VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, përmbajtjes së lëndëve dhe literaturës që përdoret, përshtatshmërisë së personelit akademik në lidhje me këtë program studimi, infrastrukturës në mbështetje të programit, mbështetjes së studentëve, sigurimit të brendshëm të cilësisë, etj.

Vizitat në institucion u kryen në datat 01.06.2022 dhe 02.06.2022. Këto vizita, si dhe i gjithë procesi i vlerësimit të jashtëm nga ekspertët u asistua nga koordinatoresha teknike e ASCAL Msc. Arjana Alija.

Universiteti "Luarasi" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 15.11.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 77/13 Prot, datë 15.11.2022. Universiteti "Luarasi" përcjell në ASCAL komentet përmes AMS dhe me anë të shkresës me Nr. 255/1 Prot., datë 16.11.2022, “Kthim përgjigje mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm”.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Informatikë Ekonomike”

I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, (në vazhdim, GVJ), u njoh me përmbajtjen e Dosjes së Vetë Vlerësimit (në vazhdim DVV) për të shqyrtuar gamën e programeve të studimit të ofruara nga Institucioni Universiteti Luarasi si edhe për të analizuar programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike. Nga shqyrtimi i kësaj dosjeje u vu re se në mënyrë të përgjithshme Institucioni është i fokusuar drejt ofrimit të programeve të studimit në fushën juridike, ekonomike dhe në teknologjinë e informacionit, fusha këto që përbëjnë prioritetet zhvillimi në vendin tonë. Në mënyrë më konkrete në Statutin e Universitetit Luarasi, Pika 3, Misioni i Institucionit përcaktohet se ky institucion punon drejt: <i>“dhënies së kontributit në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal”</i>.</p> <p>Bazuar në larminë e programeve të studimit të ofruara nga ky Universitet në kohën e përpilimit të këtij raporti (periudha maj – korrik 2022), GVJ konstaton se programet e studimit të ofruara nuk bien ndesh me interesat kombëtare pasi këto drejtime (pra ekonomike, juridike dhe teknologjia e informacionit) përbëjnë fusha me rëndësi strategjike për zhvillimin e vendit dhe përfitimin e avantazheve konkurruese.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 6 Statusi i Universitetit Luarasi</i></p>
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Për të përcaktuar plotësimin e këtij kriteri GVJ shqyrtoi në mënyrë të veçantë Statutin e Institucionit i cili në nenin 3 deklaron disa drejtime të misionit të institucionit si: „krijimi, zhvillimi dhe mbrojtja e dijeve përmes kërkimit shkencor dhe mësimdhënies; krijimin dhe mbështetjen e standardeve më të larta në mësimdhënie dhe kërkim shkencor në përputhje me kriteret e Kartës së Bolonjës; formimi i specialistëve të lartë dhe shkencëtarëve të rinj dhe bashkëpunimi kombëtar dhe rajonal“. Formulimi dhe artikulimi i këtyre elementeve në këtë formë dëshmon se Institucioni synon ruajtjen dhe konsolidimin e vetëdijes dhe individualitetit kombëtar.</p> <p>GVJ konstaton gjithashtu se programet e studimit të ofruara nga Institucioni janë në përputhje me pikat e sipërpërmendura të misionit të Institucionit por edhe me fushën e veprimtarisë së Institucionit (pra atë ekonomike, juridike dhe në teknologjinë e informacionit).</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 6 Statusi i Universitetit Luarasi</i></p>
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Në tërësinë e vet, larmia e programeve të studimit të ofruara nga Universiteti Luarasi, duke qenë se fokusohen në formimin e specialistëve të lartë dhe shkencëtarëve të rinj në fushat ekonomike, juridike dhe TI, gjykohet nga GVJ se kanë ndikim në nxitjen e zhvillimit ekonomik në vend dhe në rajon.</p>
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	

	<p>Për më tepër GVJ, mbështetur në gjykimin dhe formimin profesional të tij, është i mendimit se ofrimi i një programi studimi Bachelor në Informatikë Ekonomike i cili arrin të ndërthurë njohuri të biznesit dhe ekonomisë, me ato të teknologjisë së informacionit, plotëson nevojat për specialistë në vend dhe ndihmon në forcimin e kapaciteteve konkurruese të bizneseve kombëtare duke ofruar për këto biznese, individë të pajisur me njohje të mira në të dyja disiplinat.</p> <p>Evidenca: Evidenca 6 Statusi i Universiteti Luarasi</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>GVJ shqyrtoi përmbajtjen e DVV duke konstatuar që Institucioni ka dorëzuar si pjesë të dokumentacionit një Plan Strategjik të papërditësuar i cili mbulon vitet 2016 – 2020, vite në të cilat Institucioni njihej si Kolegji Luarasi dhe jo si Universiteti Luarasi dhe në momentin e hartimit të kësaj strategjie, fusha e teknologjisë së informacionit nuk ka qenë pjesë e fushës së veprimtarisë institucionale. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, anëtarët e GVJ u informuan se Plani i ri Strategjik për periudhën pasardhëse është në proces miratimi nga strukturat e Senatit dhe reflekton riorganizimin e Institucionit dhe programet e reja të studimit të prezantuara së fundmi prej tij. Ky kriter përmbushet në tërësinë e vet.</p> <p>Evidenca: Evidenca 9 Plani Strategjik</p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Statutit dhe Rregullores së Institucionit, por më tepër mbështetur në diskutimet gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se drejtimit prioritar akademike të institucionit janë ato në fushën e drejtësisë, ekonomike dhe në fushën e teknologjisë së informacionit. Programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike vjen si një ofertë e natyrshme që kombinon fushën ekonomike me atë të teknologjisë së informacionit që janë edhe dy nga fushat prioritarë të Institucionit.</p> <p>Evidenca: Evidenca 6 Statuti i Universitetit Luarasi Evidenca 7 Rregullore e Fakultetit</p>
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike i ofruar nga Universiteti Luarasi, është një program studimi i Ciklit të Parë me 180 kredite, i referohet nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, me formë studimi me kohë të plotë, i ofruar dhe realizuar në gjuhën shqipe, i organizuar me një kohëzgjatje normale 3 vite (6 semestra, ku çdo vit ka dy semestra). Në përfundim të studimeve, studentët diplomohen ose nëpërmjet punimit të diplomës, ose nëpërmjet një provimi të përgjithshëm dhe për</p>

	ta lëshohet diplomë universitare e ciklit të parë të studimeve: Bachelor në “Informatikë Ekonomike” e shoqëruar me suplementin e diplomës. <i>Evidenca:</i> <i>Evidenca 8 Rregullore e Programit të Studimit</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ana e Institucionit në DVV dhe më konkretisht Evidenca 8, “Rregullore e programit të studimit”, GVJ konstaton se në Nenin 4 të kësaj rregulloreje janë specifikuar qartë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë objektivat formuese të programit Bachelor në Informatikë Ekonomike. Objektivi formues kryesor është ofrimi i njohurive të nevojshme multidisiplinore për formimin e studentëve si specialistë në fushën e informatikës ekonomike.</p> <p>Në të njëjtin nen të rregullores së programit të studimit jepen njohuritë bazë, dijet dhe mundësitë e punësimit të ardhshëm të studentëve që ndjekin këtë program.</p> <p>Objektivi kryesor i programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike është të përgatisë specialistë të Teknologjisë së Informacionit, me një bagazh të konsiderueshëm teknik si informaticien të mirëfilltë, por edhe me ekspertizë në disiplina administrim biznesi dhe financë kontabilitet, që do ta bëjnë të aftë studentin të ambientohet menjëherë me kërkesat e tregut si në ambientin e njësive ekonomike private ashtu edhe ato publike. Programi ofron njohuri të formimit të përgjithshëm teorik në fushat e shkencave së informatikës, menaxhimit të biznesit, ekonomisë dhe formimit të përgjithshëm ekonomik, financës dhe kontabilitetit të ndërthurura me informatikën, menaxhimin e të dhënave, sigurinë kibernetike, etj.</p> <p><i>Evidenca:</i> <i>Evidenca 8 Rregullore e Programit të Studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Institucioni deklaroi në RVB kryerjen e analizës së tregut të punës për programet e ofruara të studimit, përpara hapjes së tij. Ky studim i kryer në nëntor të vitit 2017, pra pak para hapjes së programit të studimit ka shërbyer si bazë për konceptimin e përmbajtjes së kurrikulës së programit.</p> <p>Në vijimësi, Institucioni nuk raportoi studime të tregut të punës të cilat të përmbajnë edhe elemente të komunikimeve zyrtare me punëdhënësit dhe kërkesat dhe nevojat e tyre apo mundësitë e punësimit të studentëve, sikurse e kërkon ky kriter. Çfarë konstatohet nga përmbajtja e DVV është një evidencë (nr. 12) që përmban të dhëna për punësimin real të studentëve, por pa dhënë detaje në lidhje me vitin e fillimit dhe mbarimit të studimeve të studentëve dhe as për degën e tyre të studimeve; si edhe një evidencë (nr. 40) që demonstroi një vrojtje të kryer nga një prej pedagogëve</p>


	<p>të Institucionit me të gjithë studentët e nivelit Bachelor të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit. Kurse nga RVB në lidhje me këtë kriter konstatohet një vërtetim i kryer nga ana e zyrës së karrierës së Institucionit në lidhje me punësimin real të studentëve që kanë mbaruar detyrimet për këtë program studimi. Nga diskutimet gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua se kontaktet me punëdhënësit dhe njësitë e biznesit ruheshin në mënyrë aktive në formën e takimeve dypalëshe por akoma nuk ishin formalizuar si evente të mirëfillta nga të cilat të buronin analiza të argumentuara të nevojave të punëdhënësve.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 10 Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit.pdf</i> <i>Evidenca 12 Te dhena tabelore per punesimin real te studenteve.pdf</i> <i>Evidenca 40 Studimi pas daljes së studentëve.pdf</i></p>								
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve, garantojnë përfundimin e dijes, aftësi, shkathtësi e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Komponentët e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, si struktura e tij, objektivat formues, njohuritë bazë dhe përmbajtja, në gjykimin e GVJ duket se garantojnë ofrimin e dijes dhe aftësi të nevojshme për këtë orientim të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e tyre duke identifikuar drejtimet kryesore ku studentët mund të punësohen si: specialistë ekonomie dhe informatike për institucione publike, specialistë ekonomie dhe informatike për shoqëri private dhe specialistë për tregun e komunikimeve elektronike.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 8 Rregullore e Programit të Studimit</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi I.4
Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësive kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvijë, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV dhe pas vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se, pavarësisht se Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, që është njësia kryesore që ofron këtë program studimi është një fakultet i ri i hapur vetëm në vitin akademik 2018 – 2019, ai ka të punësuar si staf akademik me kohë të plotë dhe të ftuar, një numër të konsiderueshëm pedagogësh të cilët karakterizohen nga një formim profesional i plotë dhe i vlerësueshëm. Gjithashtu, Universiteti Luarasi është një institucion që disponon burime infrastrukturore (godina dhe biblioteka fizike dhe virtuale) të bollshme për mbulimin e nevojave të studentëve dhe stafit.</p> <p>Mbështetur në këta elemente GVJ gjykon se Universiteti Luarasi ka kapacitetet e duhura për ofrimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike.</p> <p>Evidenca: <i>Aneks Tabela Permbledhese Informatike Ekonomike.pdf</i></p>

<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit është njësia kryesore e Universitetit Luarasi që ofron këtë program studimi. Ky është një fakultet i ri i hapur në vitin akademik 2018 – 2019 dhe sipas RVB ka dy drejtime kërkimore shkencore: Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit dhe Siguria Kibernetike dhe e Informacionit. Fusha specifike e këtij programi studimi që kombinon njohuri të IT me njohuri ekonomike paraqitet në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore. Për më tepër, Universiteti Luarasi ka një Fakultet Ekonomik, një tjetër shtyllë mbështetëse e fushës së programit të studimit. Për këtë program studimi, gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se ekziston bashkëpunimi mes dy fakulteteve duke shfrytëzuar kapacitetet humane të profesoratit, kapacitetet infrastrukturore laboratorike etj.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 4 Urdher Riorganizimi Institucional.pdf</i> <i>Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Luarasi.pdf</i> <i>Evidenca 8 Rregullore Programi.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Njësia bazë e cila ofron programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike është Departamenti i Informatikës Ekonomike dhe GVJ konstaton përputhshmëri mes fushës kërkimore e akademike të njësisë bazë dhe asaj të programit specifik të studimit.</p> <p>Përsa i përket Kodifikimit kombëtar të programeve të studimit, siç parashikohet nga dispozitat e nenit 86 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Programi i Studimit i takon nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 8 Rregullore Programi.pdf</i> <i>Evidenca 15 Analizë e Departamentit përgjegjës për programin e studimit.pdf</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi I.5 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>GVJ, mbështetur në analizën e disa dokumenteve që janë pjesë e DVV, si statuti i universitetit, rregullorja e universitetit dhe rregullorja e njësisë kryesore, konstaton se Institucioni në tërësi ka parashikuar formalisht mënyrën e funksionimit të njësisë përbërëse të tij, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësisë si edhe bashkëpunimin mes zyrave organike të tij. Sipas Statutit, çdo njësi bazë dhe administrative ka funksione të mirëpërcaktuara dhe komunikon në një formë të rregulluar me njësitë e tjera, formë e cila dokumentohet dhe arkivohet për referenca të mëtejshme nga të interesuarit.</p>



	<p>Evidenca: <i>Evidenca 6 Statuti Universiteti Luarasi.pdf</i> <i>Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Luarasi.pdf</i> <i>Evidenca 7 Rregullore Fakulteti.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me universitete partnere brenda dhe jashtë vendit, si edhe me institucione të tjera ku vend të rëndësishëm zënë njësitë ekonomike dhe kompanitë e biznesit.</p> <p>Një raport i detajuar për projektet dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me Universitete të tjera jepet në evidencën 13 të DVV. Nga ana tjetër, Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi edhe me aktorë të biznesit vendas, duke qenë vetë pjesë e një grupi njësisish biznesi çka lehtëson ndërthurjen e aktiviteteve dhe krijimin e sinergjisë.</p> <p>GVJ gjykon se këto marrëveshje bashkëpunimi krijojnë një mjedis të favorshëm drejt realizimit të objektivave të procesit mësimor dhe formues të këtij programi studimi duke garantuar qasje të studentëve në fushën praktike dhe në biznes.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 13 Raport per projektet Luarasi.pdf</i> <i>Evidenca 14 Marreveshjet Erasmus tabela.pdf</i> <i>Evidenca 17 Institucionet bashkepunuese me Luarasin.pdf</i> <i>Evidenca 17.1 Raporti analitik mbi marreveshjet e bashkepunimit 2018-2022.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVB shprehet në RVB se nga ana e njësisë përgjegjëse të programit të studimit është hartuar një analizë pas diplomimit të brezit të parë të studentëve, dhe pjesë e kësaj analize është edhe shqyrtimi i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit. GVJ u fokusua në këtë evidencë, duke vlerësuar se në funksion të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike ka pasur disa botime shkencore dhe referime në konferenca të cilat vijjnë si produkt i bashkëpunimeve shkencore dhe kontribuojnë drejt rritjes së cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Pjesë e DVV u gjet edhe evidenca 17.1 e cila paraqet pikërisht një raport analitik të përfitimeve që programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike ka pasur nga marrëveshjet e bashkëpunimit.</p> <p>GVJ e konsideron të plotësuar këtë kriter.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 15 Analizë e Departamentit përgjegjës per programin e studimit.pdf</i> <i>Evidenca 17.1 Raporti analitik mbi marreveshjet e bashkepunimit 2018-2022.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Në këtë pikë, mund të referojmë listën e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Institucione bashkëpunuese me Universitetin Luarasi si edhe të dhënat në lidhje me institucionet ku studentët e programit kanë kryer praktikat mësimore. Në DVV ka edhe shumë shembuj të marrëveshjeve të bashkëpunimit me entitete të tjera, si me Akademinë e Sigurisë, Universitetin Politeknik të Tiranës, etj. Bazuar në informacionin e dhënë në këto dokumente dhe për më tepër bazuar në diskutimet me studentët, GVJ gjykon se ky kriter plotësohet.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 17 Institucionet bashkepunuese me Luarasin.pdf</i> <i>Evidenca 18 Institucionet ku jane kryer praktikat mesimore.pdf</i> <i>Evidenca 19 Udhezues per zhvillimin e praktikes.pdf</i></p>

Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Në këtë pikë të RVB deklarohet vetëm për praktikat profesionale të zhvilluara me studentët. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ diskutoi me dekanin e njësisë kryesore që ofron programin e studimit dhe u informua se janë bërë plane për të ruajtur kontaktet e mëtjshme me studentët e diplomuar duke marrë njëkohësisht edhe feedback nga punëdhënësit pranë të cilëve janë punësuar këta studentë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1

Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Nga shqyrtimi i Rregullores së programit të studimit, Planit Mësimor si edhe syllabuseve, GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike i ofruar në Universitetin Luarasi, i referohet nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi (Ligji për Arsimin e Lartë 80/2015) dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Programi i studimit është me kohë të plotë me një kohëzgjatje 3 vjet dhe 6 semestra në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare e nivelit të parë, “Bachelor”.</p> <p>Nga shqyrtimi i nenit 5 të rregullores së programit si edhe i planit mësimor të Programit të Studimit, GVJ konstaton se disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në programin e studimit janë të organizuara në 5 kategori, nga A në E, në përputhje me VKM nr. 41. Disiplinat mësimore të ofruara në kategoritë A, B, C, D dhe E janë të ndërthurura, të detyrueshme dhe me zgjedhje dhe vlerësohen me kredite. (Sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar, dhe VKM nr. 879, datë 18.12.2019, në kategorinë A bëjnë pjesë disiplina të formimit të përgjithshëm për përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme; në kategorinë B, që janë lëndët karakterizuese përfshihen disiplina të formimit bazë të programit për përgatitje teorike dhe</p>

	<p>shkencore; në kategorinë C përfshihen lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje; në kategorinë D përfshihen lëndët plotësuese si dhe praktika profesionale. Ndërsa në kategorinë E janë detyrimet përmblyëse për diplomim.)</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 8 Rregullore Programi.pdf</i> <i>Evidenca 11 Programi i studimit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh.</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor të programit të studimit, GVJ konstaton se tërësia e lëndëve të përfshira në programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike ofron një mbulim të mjaftueshëm të disiplinave specifike në fushat e ekonomisë, biznesit, financë - kontabilitetit, dhe teknologjisë së informacionit. Programi ofron një larmi disiplinash si formimin e aftësive profesionale në programim, menaxhim të bazës së të dhënave, siguri të TI të ndërthurura me njohuri mbi ekonominë, financën, kontabilitetin, marketingun, etj.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 11 Programi i studimit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparura në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit specifikohet se Programi Bachelor në Informatikë Ekonomike i përket Nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), dhe synon “dhënien e një tërësie njohurish në formimin e përgjithshëm teorik në fushën e shkencave të informatikës dhe të ekonomisë me objektiv kryesor formimin e specialistëve të lartë e të aftë për të punuar në fushën e informatikës ekonomike dhe për realizimin e studimeve të avancuara në këtë fushë”.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të Programit të Studimit dhe më tej të Syllabuseve të Lëndëve, GVJ konstaton se në tërësi ky program planifikon të japë njohuri të kompletuara teorike dhe akademike në fushat e studimit biznes/ekonomi dhe teknologji informacioni si edhe i aftëson studentët për punësim të mëtejshëm. Ndërthurja e lëndëve paraqitet në përgjithësi e kompletuar për të aftësuar studentët e programit të kuptojnë parimet akademike të të dyja disiplinave. Kjo u konfirmua edhe nga pedagogët në takimin që GVJ zhvilloi, me ta dhe sipas tyre kjo ishte një ndër pikat e forta të programit të studimit.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 8 Rregullore Programi.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Nga shqyrtimi që GVJ i bëri planit mësimor konstatoi se Programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin Luarasi paraqitet i strukturuar në përputhje me Ligjin 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Elementët e programit të studimit janë në përputhje kryesisht me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM), nr.41, datë 24.01.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” i ndryshuar me VKM nr. 879 dt. 18.12.2019. Ai është i organizuar në pesë disiplinat formuese (A – E), ka 180 kredite, zgjat tre vite akademike, mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, dhe është i detyrueshëm për frekuentim në masën 100% për elementet punë laborator, detyra dhe projekte. Vlerësimi është i vazhdueshëm gjatë vitit dhe mbështetet në disa komponentë.</p> <p>Syllabuset e lëndëve të programit të studimit paraqiten kryesisht në përputhje me aktet ligjore dhe konkretisht VKM nr.41 përsa i përket strukturimit të tyre. Një element që u konstatua se përgjithësisht nuk zbatohet në programet lëndore ishte detajimi i çështjeve në nënçështje</p>

	<p>dhe shpjegimi (rreth një paragraf) i çdo teme të leksionit sipas javëve, shoqëruar me literaturën përkatëse (të detajuar me faqe, sipas kërkesave të shtojcës nr.2 të VKM 41 dhe shtojcës 3 të VKM 879). Gjithashtu u vu re një mangësi në përcaktimin dhe shprehjen e qartë të njohurive, aftësive dhe kompetencave që studentët priten të përvetësojnë në përfundim të çdo lënde.</p> <p>Kjo mospërputhje u diskutua edhe gjatë vizitës në Institucion si një çështje e karakterit teknik të përmbajtjes së programit dhe që pritet të përmirësohet më tej ndërkohë që edhe vetë formatet e syllabusëve janë në përmirësim të vazhdueshëm nga autoritetet përkatëse rregullatore.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 8 Rregullore Programi.pdf</i> <i>Evidenca 11 Programi i studimit.pdf</i> <i>Syllabus IE Viti I 18-19.pdf</i> <i>Syllabus IE Viti III 21-22.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Siç evidentohet nga Rregullorja e programit të studimit, neni 5, shpërndarja e lëndëve dhe moduleve sipas kategorive A - E, në ECTS për programin e studimit është si më poshtë: <i>Sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar, ndarja në kategoritë është si më poshtë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A (lëndët e formimit të përgjithshëm /bazë): – gjithsej 31 ECTS, pra 17% (<i>Sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar duhet të jetë 15 - 20% e totalit</i>) - Kategoria B (lëndë të formimit karakterizues: gjithsej 91 ECTS, pra 50% (<i>Sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar duhet të jetë 50 - 55% e totalit</i>). - Kategoria C (lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje): gjithsej 31 ECTS (17%) (<i>Sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar duhet të jetë 12 - 15% e totalit</i>). - Kategoria D (lëndë plotësuese dhe praktika profesionale): gjithsej 18 ECTS (10%) (<i>Sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar duhet të jetë 10 - 15% e totalit</i>) - Kategoria E (detyrimet përmbyllëse: punim diplome ose provimi përfundimtar gjithëpërfshirës): gjithsej 9 ECTS (5%) (<i>Sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar duhet të jetë 3 - 5% e totalit</i>). <p>Evidenca: <i>Evidenca 8 Rregullore Programi.pdf</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p style="margin: 0;">X</p>				

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Universiteti Luarasi është riorganizuar nga Kolegj Universitar në Universitet në vitin 2019 me urdhrin numër 494, dt 11.10.2019 të Ministrisë të Arsimit, Rinisë dhe Sporteve. Pas këtij riorganizimi, Universiteti kishte në përbërjen e tij tre fakultete: Fakultetin e Drejtësisë, Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, Fakultetin e Ekonomisë. Së fundmi Universiteti ka hapur edhe fakultetin e katërt, atë</p>

	<p>të Shkencave Mjekësore. Universiteti është akredituar për herë të parë si institucion me vendimin numër 52, të Bordit të ASCAL, dt 27.11.2020. Njësia kryesore përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike është Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit i cili është themeluar në 14.05.2018 nëpërmjet urdhrin nr. 266 të MASR. Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit është Departamenti i Informatikës Ekonomike. Përveç këtij departamenti, pjesë e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit janë edhe dy departamente të tjera: Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, dhe Departamenti i Matematikës dhe Statistikës.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike i organizuar në përputhje me sistemin e Bolonjës, është hapur me urdher Nr. 417, datë 16.07.2018 të MASR dhe aplikon për herë të parë për akreditim.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 4 Urdher Riorganizimi Institucional.pdf</i> <i>Evidenca 2.1 Vendim Akreditimi Institucional.pdf</i> <i>Evidenca 2 Urdher Per hapjen e Fakultetit.pdf</i> <i>Evidenca 7 Rregullore Fakulteti.pdf</i></p>																																		
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Në këtë pikë të RVB Institucioni raporton se Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit si njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit cakton një person në rolin e koordinorit të programit. Koordinatori është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij dhe informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse, por RVB nuk jep detaje konkrete në lidhje me këtë dhe GVJ nuk hasi as dokumentacion mbështetës në DVV. Pyetur gjatë vizitës në Institucion, u kërkua evidencë shtesë e cila u plotësua nga Institucioni.</p>																																		
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Mbështetur në kërkesat e nenit 23 të Ligjit për Arsimin e Lartë, “Fakulteti organizohet në së paku tri njësi bazë, së paku dy prej të cilave janë departamente”, GVJ konfirmon se Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit i Universitetit Luarasi, përbëhet nga tre departamente/njësi bazë:</p>																																		
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Informatikës Ekonomike • Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, • Departamenti i Matematikës dhe Statistikës. <p>Referuar tabelave në anekset e RVB, GVJ konstaton se Departamenti i Informatikës Ekonomike, i cili është edhe njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, përmbush kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit (<i>më specifikisht, ka minimumi 7 pedagogë të brendshëm nga të cilët të paktën 3 janë me tituj/grada</i>).</p> <p>Të dhëna analitike në lidhje me përbërjen e stafit të Departamentit të Informatikës Ekonomike paraqiten më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="751 1733 1294 2011"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Dep i Informatikës ekonomike</th> <th colspan="2">2018-2019</th> <th colspan="2">2019-2020</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof.As</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr</td> <td>2</td> <td>3</td> <td>2</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>MSc</td> <td>4</td> <td>-</td> <td>4</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td>7</td> <td>4</td> <td>7</td> <td>3</td> </tr> </tbody> </table>	Dep i Informatikës ekonomike	2018-2019		2019-2020		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	1	1	1	1	Prof.As	-	-	-	-	Dr	2	3	2	2	MSc	4	-	4	-	Total	7	4	7	3
Dep i Informatikës ekonomike	2018-2019		2019-2020																																
	PAE	PAK	PAE	PAK																															
Prof.Dr	1	1	1	1																															
Prof.As	-	-	-	-																															
Dr	2	3	2	2																															
MSc	4	-	4	-																															
Total	7	4	7	3																															

PNA	2	2
-----	---	---

Dep i Informatikës ekonomike	2020-2021		2021-2022	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	1	1	1	1
Prof.As	-	-	-	1
Dr	2	3	2	3
MSc	4	1	4	3
Total	7	5	7	8
PNA	2		2	

Çfarë bie në sy në ecurinë e numrave të personelit akademik të Departamentit të Informatikës Ekonomike është qëndrueshmëria e stafit akademik efektiv në katër vitet e shqyrtuara si edhe asistenca nga personeli ndihmës akademik.

Evidenca:

Aneks Tabela Permbledhese Informatike Ekonomike.pdf

Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.

Siç u përmend edhe më lart GVJ konfirmon se Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit i Universitetit Luarasi, përbëhet nga tre departamente/njësi bazë: Departamenti i Informatikës Ekonomike; Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit; Departamenti i Matematikës dhe Statistikës.

Referuar tabelave në shtojcat e RVB, të dhënat analitike në lidhje me përbërjen e stafit të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit paraqiten më poshtë:

Fakulteti i IT dhe Inovacionit	2018-2019		2019-2020	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	2	1	3	2
Prof.As	2	2	2	6
Dr	5	8	5	8
MSc	12	5	11	6
Total	21	16	21	22
PNA	2		2	

Fakulteti i IT dhe Inovacionit	2020-2021		2021-2022	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	3	3	2	3
Prof.As	2	6	3	7
Dr	5	10	4	9
MSc	11	7	12	13
Total	21	26	21	32
PNA	2		2	


Çfarë bie në sy nga analiza e numrave dhe kualifikimit të njësive kryesore ndër vite është ruajtja e shkallës së kualifikimit të personelit akademik efektiv dhe rritja e vazhdueshme e numrit dhe kualifikimit të stafit akademik me kontratë. Pjesë e këtyre të fundit janë profesorë të njohur në vend dhe me kontribut në fushat shkencore respektive.

Evidenca:


Aneks Tabela Permbledhese Informatike Ekonomike.pdf

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi II.3 Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ shqyrtoi dokumentacionin që është dorëzuar në DVV si edhe informacionet publike të Institucionit në faqen e tij të Internetit dhe konstatoi se në përgjithësi informacionet për elementet e rëndësishme të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike disponohen nga Fakulteti (njësia kryesore) dhe Departamenti (njësia bazë) si edhe janë publike dhe të mundshme për t'u aksesuar lirisht, madje edhe në gjuhën angleze.</p> <p>Bazuar në diskutimet e kryera me pedagogët dhe studentët e programit të studimit gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua se studentët kanë informacion në lidhje me programin e studimit edhe nëpërmjet platformës elektronike mësimore, Moodle. Sipas konfirmimit nga studentët e programit në fillim të çdo semestri studentëve iu vihen në dispozicion dhe ju prezantohen syllabuset për çdo lëndë që ofrohet.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 8 Rregullore Programi.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e Rregullores, Planit Mësimor dhe programeve lëndore të Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se organizimi i veprimtarisë mësimore vjetore është me kohë të plotë, shtrihet në tre vite akademike secili me nga dy semestra që kanë kohëzgjatje normale deri në 15 javë (pika 1, neni 11 i rregullores së programit të studimit). Programi i plotë shtrihet në 6 semestra, në të cilin trajtohen lëndët të cilat janë të vlerësuar me kredite sipas sistemit evropian, ECTS.</p> <p>Programi i studimit ofron gjashtë lëndë në çdo semester akademik, secila prej lëndëve me 4, 5 ose 6 ECTS për secilën lëndë për katër semestrat e parë të studimeve. Në semestrin e pestë dhe të gjashtë studentët marrin përkatësisht nga pesë dhe katër lëndë, ndër të cilat edhe lëndë me zgjedhje, dhe në përfundim diplomohen ose me punim diplome ose nëpërmjet provimit të përgjithshëm gjithëpërfshirës që vlerësohen me 9 ECTS. Praktika dhe zhvillimi i karrierës paraqitet si disiplinë e detyrueshme me 6 ECTS e ofruar në semestrin e gjashtë.</p> <p>Ky program studimi është i organizuar në module të detyrueshme dhe lëndë me zgjedhje. Programi i studimit përmban ndër të tjera edhe orë seminari por çfarë bie në sy nga Plani Mësimor është se aty nuk përmenden orë laboratorit të cilat janë të detyrueshme sipas kërkesave të ligjit nr. 80/2015 për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. Orët e laboratorit përmenden megjithatë në rregulloren e programit të studimit dhe zhvillohen në realitet dhe gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua se orët e laboratorit përfshihen në orët e seminarit për çdo lëndë.</p> <p>Evidenca:</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Evidenca:</p>



	<p><i>Evidenca 8 Rregullore Programi.pdf</i> <i>Evidenca 11 Programi i studimit.pdf</i> <i>Sylabus IE Viti III 21-22.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Për këtë kriter, GVJ shqyrtoi rregulloren e programit të studimit, Planin Mësimor të tij si edhe programet lëndore duke konfirmuar se ky kriter përmbushet pasi programet lëndore përmbajnë ngarkesën e mësimin në ECTS si edhe në leksione dhe seminare. Plani Mësimor paraqet për çdo lëndë kategorinë ku ajo përfshihet, orët mësimore në auditor dhe jashtë auditorit si edhe kreditet përkatëse.</p> <p>Elemente në lidhje me shkallën e frekuentimit të secilës lëndë dhe mënyrën e vlerësimit të tij sigurohen në programet lëndore. Ndjekja e programit është e detyrueshme në shkallën 50% të leksioneve, 75% të seminareve (ref: programet lëndore) dhe 100% të punëve laboratorike (ref: rregullorja e programit). Format e kontrollit të njohurive variojnë në çdo lëndë të vecantë por në mënyrë të përmbledhur janë paraqitur në tabelën 15 në shtojcat e RVB:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive 10% • Plotësimi i detyrimeve (lab/detyra kursi) 20% • Testimet gjatë vitit 30% • Provimi përfundimtar 40% • Totali 100% <p>GVJ konstaton se ka disa programe lëndore ku kjo shpërndarje varion (psh, lënda “dizenjim, menaxhim, implementim i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit” për vitin akademik 2021-2022) duke reflektuar autonominë akademike të stafit.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 8 Rregullore Programi.pdf</i> <i>Evidenca 11 Programi i studimit.pdf</i> <i>Sylabus IE Viti III 21-22.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Përsa i përket pranimeve të studentëve në programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin Luarasi, GVJ gjen informacion të publikuar në faqen e internetit të Institucionit si në shqip ashtu edhe në anglisht, dhe informacion zyrtar në rregulloren e programit të studimit. Rregullorja e këtij programi në nenin 6 rendit kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit të studentëve të cilët duhet të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vërtetojnë me dokument zyrtar përfundimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë vendit (të ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit). 2. Plotësojnë kriterin e notës mesatare minimale sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave. 3. Renditja e aplikantëve kryhet duke u bazuar në kriteret e mëposhtme: <ol style="list-style-type: none"> 1. 70% e notës mesatare aritmetike të shkollës së mesme, përfshirë provimet e maturës shtetërore; 2. 30% mesataren për lëndët e provimeve me zgjedhje të maturës shtetërore. <p>Lëndët me zgjedhje të maturës shtetërore janë si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • “Bachelor” në “Informatikë Ekonomike” – Ekonomi 15%, Gjuhë e Huaj 15%. <ol style="list-style-type: none"> 4. Plotësojnë kriteret e tjera të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. <p>Në lidhje me transferimet dhe ekuivalentimet e studimeve, GVJ ndeshi informacion në nenin 60 të Statutit të Institucionit dhe</p>



	<p>informacion akoma më të detajuar dhe specifik në nenin 8 të rregullores së programit të studimit ku vëren se Institucioni ka implementuar rregulla të qarta dhe transparente për transferimet në vitet ndërmjetëse të studimeve. Ekuivalentimi i lëndëve për studentët që kërkojnë transferim në hyrje kryhet nga një komision i posaçëm i ngritur për këtë qëllim dhe ndjek rregulla të mirëpërcaktuara në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>U shqyrtuan gjithashtu edhe tabelat e RVB (tabela 21), dhe u pyet edhe gjatë vizitës në Institucion duke konfirmuar që për këtë program studimi ka pasur: 3 transferime në hyrje në vitin akademik 2018-2019; 7 transferime në hyrje në vitin akademik 2019-2020; 11 transferime në hyrje në vitin akademik 2020-2021; 11 transferime në hyrje në vitin akademik 2021-2022. Nuk specifikohen transferime në dalje nga programi i studimit.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 6 Statuti Universiteti Luarasi.pdf</i> <i>Evidenca 8 Rregullore Programi.pdf</i> https://luarasi-univ.edu.al/kriteret-e-pranimit-2017-2018/#1529400853815-8fcee05e-9c3b</p>				
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Për të analizuar këtë kriter, GVJ ka shqyrtuar programet lëndore përkatëse të programit të studimit të cilat janë pjesë e DVV (një nga referencat jepet edhe në fund të këtij kriteri si ilustrim). Referuar këtyre të dhënave GVJ konstaton se syllabusi i cdo lënde përmban informacionet e nevojshme të detajuara, në lidhje me praktikat në auditor, seminarat (nëse ka) dhe orët laboratorit (nëse ka) në përputhje kjo me VKM nr.41 të ndryshuar, si edhe mënyrën e vlerësimit që ndjek çdo pedagog, e cila ka variacione vetëm sporadike në ndonjë lëndë specifike (shiko kriteri 4 më lart në këtë standard). Vihet re se nota përfundimtare e studentit është rezultante e këtyre elementëve të vlerësimit: provimet + detyra kursi/projekte individuale + diskutimet në seminare.</p> <p>Evidenca: <i>Syllabus IE Viti III 21-22.pdf</i></p>				
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Referuar neneve 24 dhe 26 të Statutit të Institucionit, Përgjegjësi i njësisë kryesore dhe ai i njësisë bazë, pra në këtë rast Dekani i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit dhe Përgjegjësi i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit kanë si pjesë të funksioneve të tyre edhe miratimin e programeve mësimore. Sipas konfirmimeve në Institucion, procedurat për përmirësimin e programit zakonisht ndërmerren në fillim të cdo viti akademik dhe mund të vijnë edhe si iniciativë e pedagogëve të programit të studimit.</p> <p>Në Shtojcat e RVB (tabela 11) ku duhet të paraqiten ndryshimet që kanë ndodhur në përmbajtjen e programit të studimit gjenden zero ndryshime. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua se ndryshime që kanë rezultuar në prezantimin e lëndëve të reja nuk kishin ndodhur, por më tepër ka pasur përmirësime në përmbajtjen e programeve lëndore të lëndëve të ofruara me kapituj të rinj apo zhvendosje të lëndëve në semestra të ndryshëm. Synimi i njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit ka qenë konsolidimi fillestar i kurrikulës së programit e më pas përmirësimi gradual i tij.</p>				
	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="643 1944 802 2011">Nuk përmbushet</td> <td data-bbox="802 1944 1018 2011">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="1018 1944 1233 2011">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1233 1944 1471 2011">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		



Shkalla e përmbushjes së standardit				X
-------------------------------------	--	--	--	---

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	<p>Në lidhje me ngarkesën e programit, niveli 6 i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, referuar Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”, neni 73 pika 1, kërkon që programet e ciklit të parë të studimit, të organizohen me <u>jo më pak se 180</u> kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre të jetë tri vite akademike.</p> <p>Mbështetur në Statutin e Institucionit dhe në rregulloren e programit të studimit GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin Luarasi është i hartuar dhe organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, është i shtrirë në tre vite akademike me nga 60 ECTS cdo vit, të cilat plotësojnë kërkesën për 180 ECTS në total. Ky kriter pra plotësohet.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 6 Statuti Universiteti Luarasi.pdf</i> <i>Evidenca 8 Rregullore Programi.pdf</i></p>
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	<p>GVJ, duke gjykuar në bazë të dokumentacionit të dorëzuar nga Institucioni në DVV, (Plani Mësimor i programit të studimit, programet lëndore, baza e literaturës së detyrueshme dhe të sugjeruar për t’u përdorur, përgatitja akademike dhe kërkimore e profesorit), është e mendimit se programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, mundëson aftësimin e studentëve dhe pajisjen e tyre me kompetencat e përfshira në programet lëndore dhe me aftësi për t’u punësuar në treg në përfundim të studimeve.</p> <p>Të pyetur për mjaftueshmërinë e njohurive dhe aftësive që kishin fituar gjatë studimeve, studentë të programit u shprehën konfidentë për punësimin e tyre pranë njësive të biznesit duke ndarë edhe përvojat e tyre pozitive.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 11 Programi i studimit.pdf</i> <i>Evidenca 15 Analizë e Departamentit përgjegjës për programin e studimit.pdf</i> <i>Sylabus IE Viti III 21-22.pdf</i></p>
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	<p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të programit të studimit që është pjesë e DVV, GVJ konstaton se shpërndarja e ngarkesës mësimore të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin Luarasi, përgjatë tre viteve akademike sipas lëndëve është përgjithësisht e mirë menduar dhe e balancuar dhe mundëson kryesisht arritjen e objektivave formuese të programit dhe rezultatet e pritshme të të nxënit. (Objektivat formuese të këtij programi studimi specifik dhe rezultatet e pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional gjenden në rregulloren e programit të studimit).</p> <p>Evidenca:</p>

<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p><i>Evidenca 11 Programi i studimit.pdf</i></p> <p>GVJ pasi shqyrtoi tabelat në RVB si edhe programet lëndore (të dorëzuara në DVV) të disiplinave formuese të ofruara në programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin Luarasi, konstaton se këto disiplina ofrojnë nivel përgjithësisht të kënaqshëm në përputhje me profilin dhe fushën e programit. Emërtimi i tyre paraqet ngjashmëri me programe ndërkombëtare të kësaj disipline, sipas njohjes që anëtarët e GVJ kanë me programe studimi ndërkombëtare në fushën e Informatikës Ekonomike.</p> <p>Evidenca: <i>Syllabus IE Viti III 21-22.pdf</i></p>												
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Përsa i përket strukturës së programit, në tabelën 13 në anekset plotësuese të mund të gjendet informacion në shkallë të përmbledhur në lidhje me ngarkesën totale të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin Luarasi. Nga kjo tabelë shohim elementet e mëposhtme të ngarkesës totale:</p> <table border="0"> <tr> <td>• Leksione</td> <td>960 orë</td> </tr> <tr> <td>• Seminare (Ushtrime / Laborator)</td> <td>795 orë</td> </tr> <tr> <td>• Kontrolli i vazhdueshëm / praktika në auditor</td> <td>0 orë</td> </tr> <tr> <td>• Praktikë profesionale</td> <td>60 orë</td> </tr> <tr> <td>• Diploma/ Provim Formimi</td> <td>100 orë</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td>1.915 orë</td> </tr> </table> <p>Raporti Teori (leksione) / Praktikë (sem+usht+proj+prakt prof) rezulton 960 orë teori / 955 ore, ose afërsisht 50% / 50%. GVJ vlerëson pozitivisht peshën e orëve të praktikës ku përfshihen seminare, ushtrime, laboratore dhe praktika profesionale.</p> <p>Evidenca: <i>Aneks Tabela Permbledhese Informatike Ekonomike.pdf</i></p>	• Leksione	960 orë	• Seminare (Ushtrime / Laborator)	795 orë	• Kontrolli i vazhdueshëm / praktika në auditor	0 orë	• Praktikë profesionale	60 orë	• Diploma/ Provim Formimi	100 orë	Totali	1.915 orë
• Leksione	960 orë												
• Seminare (Ushtrime / Laborator)	795 orë												
• Kontrolli i vazhdueshëm / praktika në auditor	0 orë												
• Praktikë profesionale	60 orë												
• Diploma/ Provim Formimi	100 orë												
Totali	1.915 orë												
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Në lidhje me periodicitetin e përmirësimit të lëndëve dhe moduleve të programit të studimit, RVB e përgatitur nga Institucioni referon se ato përditësohen në mënyrë periodike me fokus literaturën bazë dhe të detyrueshme të programit të studimit.</p> <p>Megjithëkëtë, nga një shqyrtim jo shterues që GVJ i bëri programeve lëndore të dorëzuara si pjesë e DVV, konstatohet që ka disa programe lëndore të cilat nuk janë të përditësuara me literaturë të pesë viteve të fundit, dhe sa për të dhënë vetëm disa prej shembujve si më poshtë jepen disa programe të vitit akademik 2021 – 2022</p> <ul style="list-style-type: none"> • Menaxhim i Rrjetave kompjuterike, literaturë bazë e detyrueshme e vitit 2010. • Hyrje në teorinë e bazës së të dhënave (nuk referohet fare viti i literaturës bazë të detyrueshme). • Inteligjencë Biznesi dhe Data Mining, literaturë bazë e detyrueshme e vitit 2014. <p>Sugjerojmë përditësim në literaturë të të gjitha lëndëve pasi që Institucioni disponon marrëveshje bashkepunimi me shtëpi botuese prestigjioze të cilat kanë publikime cilësore të viteve të fundit për të njëjtët tituj dhe autorë.</p> <p>Evidenca: <i>Syllabus IE Viti III 21-22.pdf</i></p>												
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara</p>	<p>Bazuar në analizën e titujve dhe përmbajtjes së syllabuseve për të tre vitet akademike të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin Luarasi, GVJ arrin në përfundimin se në</p>												


<p>për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>përgjithësi përmbajtja e programit të studimit, përsa i përket titujve të lëndëve, tipologjisë së tyre (A-E), kombinimit të tyre mes dy disiplinave biznes/ekonomi nga një anë dhe informatikë dhe IT nga ana tjetër si edhe raporti teori / praktikë mundëson plotësisht përfundimin e dijeve dhe aftësive nga ana e studentëve të kompetencave teknike të synuara për një program të ciklit të parë. Përsa i përket aftësive teknike në profesion, syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi paraqiten gjithashtu të kompletuara.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 11 Programi i studimit.pdf</i> <i>Syllabus IE Viti III 21-22.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Bazuar në analizën që GVJ i bëri syllabuseve të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin Luarasi për të tre vitet e studimit, konstaton se në vija të përgjithshme përmbajtja e programit të studimit jep sfondin e kërkuar të nevojshëm për vijimin e mëtejshëm të studimeve. Po kështu, larmia e njohurive dhe dijeve që synon të përcojë ky program studimi i aftëson studentët për t'u përshtatur me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës së këtij profesioni si në njësi ekonomike vendase po ashtu edhe të huaja. Megjithatë, në elemente të veçanta, ekziston mundësia që programi i studimit të mund të pasurohet në përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve që ofron, dhe sidomos në gamën e lëndëve me zgjedhje në përbërjen e tij. Këto elemente do të përgatisnin edhe më shumë studentët si për tregun e punës ashtu edhe për vijimin e mëtejshëm të studimeve si edhe do të reflektonin ndryshimet dhe risitë më të fundit në fushën e informatikës ekonomike.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 11 Programi i studimit.pdf</i> <i>Syllabus IE Viti III 21-22.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Në këtë kriter, RVB specifikon aktivitete si organizimi i konferencave shkencore. Për arsye të mungesës së dokumentacionit në DVV për këtë kriter, gjatë vizitës në Institucion, GVJ pyeti në lidhje me këto aktivitete dhe përgjegjësi i njësisë kryesore u shpreh se Institucioni synon të jetë sa më afër tregut të punës që vetë studentët të marrin njohuri sa më të vlefshme për praktikën. Ka takime të shpeshta me kompani biznesi private të cilët shprehen hapur për nevojat e tyre. Është qasje e Institucionit që të marrin ide nga kompanitë dhe t'i përfshijnë këto reflektime tek syllabuset. Synimi i tyre është që mësimi të përcohet i bazuar tek studentët dhe i organizuar rreth nevojave që tregu i punës ka për përgatitjen e studentëve kjo edhe në të mirë të emrit të Institucionit në treg.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve



Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.

Njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin Luarasi është Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit që është pjesë e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, por në mësimdhënie në këtë program studimi angazhohen edhe pedagogë nga njësi të tjera të Institucionit, si nga Fakulteti i Ekonomisë, apo departamente të tjera.

Në RVB të përgatitur nga Institucioni në këtë kriter referohet thjesht se për këtë program studimi janë angazhuar 26 Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe 14 Personeli Akademik me Kontratë (PAK) me grada dhe tituj sipas kërkesave ligjore. GVJ shqyrtoi edhe tabelat mbështetëse të RVB dhe konstaton se Institucioni i përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Më konkretisht, VKM Nr. 418, viti 2017, pika b, ii, kërkon që Personeli akademik me kohë të plotë (PAE) të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore të cdo programi studimi, cka nënkupton se personeli akademik me kontratë duhet të angazhohet në më pak se 30 % të orëve mësimore të programit të studimit.

Në mënyrë më të detajuar dhe referuar të dhënave (tabela 7 në anekset e RVB), më poshtë jepet përbërja e stafit akademik për vitet akademike që nga fillimi i tij.

- GJITHSEJ për vitin akademik **2021 – 2022** kanë dhënë mësim **40 pedagogë** nga të cilët **26 PAE** dhe **14 PAK** (65%/35%)
- GJITHSEJ për vitin akademik **2020 – 2021** kanë dhënë mësim **38 pedagogë** nga të cilët **27 PAE** dhe **11 PAK** (71%/29%)
- GJITHSEJ për vitin akademik **2019 – 2020** kanë dhënë mësim **33 pedagogë** nga të cilët **25 PAE** dhe **8 PAK** (76%/24%)
- GJITHSEJ për vitin akademik **2018 – 2019** kanë dhënë mësim **20 pedagogë** nga të cilët **15 PAE** dhe **5 PAK** (75%/25%)

Stafi akademik i programit të studimit	2021 – 2022		2020 – 2021	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	2	<u>1</u>	2	<u>1</u>
Prof.As.Dr	4	4	4	4
Dr/PhD	7	5	8	5
Msc	13	4	13	1
Total	26	14	27	11


Stafi akademik i programit të studimit	2019-2020		2018 – 2019	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	4	0	<u>2</u>	
Prof.As.Dr	3	3	3	2
Dr/PhD	4	5	2	3
Msc	14	0	8	0
Total	25	8	15	5

Bie në sy rritja e vazhdueshme e PAK të cilët në vitin e fundit akademik kalojnë përtej minimumit të lejuar të angazhimit të tyre.

Për vitet respektive, dhe sidomos për vitin 2021 – 2022 ku duket sikur ka rënë numri i PAE kundrejt PAK, GVJ ka shqyrtuar edhe raportin e orëve mësimore që kryhen nga PAE kundrejt orëve që kryhen nga PAK për këtë program studimi për të konfirmuar përmbushjen e kriterit sipas VKM nr 418, viti 2017. Referencë: Tabelat 12 në anekset e RVB.


Sipas kësaj analize GVJ konstaton sa më poshtë:

	<p>Për vitin 2021 – 2022, PAE realizojnë gjithsej 1935 orë mësimore kurse PAK 705 orë mësimore nga 2640 orë në total; pra orët e realizuara nga PAE dhe PAK qëndrojnë në raportin (73%/27%) duke përmbushur kështu kërkesat e VKM Nr. 418. Pra, pavarësisht se në këtë vit akademik raporti i numrit të PAE kundrejt PAK nuk plotësohet, raporti i ngarkesës mësimore që përballon secili grup përmbushet.</p> <p>Për vitin 2020 – 2021, PAE realizojnë gjithsej 1950 orë mësimore kurse PAK 690 orë mësimore nga 2640 orë në total; pra orët e realizuara nga PAE dhe PAK qëndrojnë në raportin (74%/26%) duke përmbushur kështu kërkesat e VKM Nr. 418.</p> <p>Për vitin 2019 – 2020, PAE realizojnë gjithsej 1710 orë mësimore kurse PAK 390 orë mësimore nga 2100 orë në total; pra orët e realizuara nga PAE dhe PAK qëndrojnë në raportin (81%/19%) duke përmbushur kështu kërkesat e VKM Nr. 418.</p> <p>Për vitin 2018 – 2019, PAE realizojnë gjithsej 750 orë mësimore kurse PAK 300 orë mësimore nga 1050 orë në total; pra orët e realizuara nga PAE dhe PAK qëndrojnë në raportin (71%/29%) duke përmbushur kështu kërkesat e VKM Nr. 418.</p> <p>Evidenca: <i>Aneks Tabela Permbledhese Informatike Ekonomike.pdf Referencë: Tabelat 7 dhe 12 në anekset e RVB</i></p>																																																																									
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i të dhënave në DVV, GVJ vuri re se një pjesë e konsiderueshme e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, kishte titullin Master Shkencor, Msc por në një pjesë prej tyre janë kandidatë për doktorë.</p>																																																																									
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<table border="1" data-bbox="724 1039 1342 1630"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Stafi akademik i programit të studimit</th> <th colspan="2">2021 – 2022</th> <th colspan="2">2020 – 2021</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof.As.Dr</td> <td>4</td> <td>4</td> <td>4</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>7</td> <td>5</td> <td>8</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>13</td> <td>4</td> <td>13</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td>26</td> <td>14</td> <td>27</td> <td>11</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <th rowspan="2">Stafi akademik i programit të studimit</th> <th colspan="2">2019-2020</th> <th colspan="2">2018 – 2019</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>4</td> <td>0</td> <td>2</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Prof.As.Dr</td> <td>3</td> <td>3</td> <td>3</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>4</td> <td>5</td> <td>2</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>14</td> <td>0</td> <td>8</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td>25</td> <td>8</td> <td>15</td> <td>5</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga shqyrtimi i tabelës 7 në anekset e RVB vihet re se në vitin e fundit akademik 2021 – 2022, 4 prej PAE me titullin Msc. janë kandidatë për doktorë.</p> <p>GVJ shqyrtoi edhe CV të PAE dhe PAK të angazhuar në programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin Luarasi dhe gjykon se sfondi i formimit akademik, praktik dhe kërkimor i personelit shfaqet në përgjithësi, në përputhje me angazhimin e tyre në këtë program studimi. Nga shqyrtimi i CV të personelit u konstatua se ata i kanë fituar gradat shkencore dhe / ose titujt në disiplina që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me programin e studimit si informatikë, menaxhim, kontabilitet/financë.</p>	Stafi akademik i programit të studimit	2021 – 2022		2020 – 2021		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	2	1	2	1	Prof.As.Dr	4	4	4	4	Dr/PhD	7	5	8	5	Msc	13	4	13	1	Total	26	14	27	11						Stafi akademik i programit të studimit	2019-2020		2018 – 2019		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	4	0	2		Prof.As.Dr	3	3	3	2	Dr/PhD	4	5	2	3	Msc	14	0	8	0	Total	25	8	15	5
Stafi akademik i programit të studimit	2021 – 2022		2020 – 2021																																																																							
	PAE	PAK	PAE	PAK																																																																						
Prof.Dr	2	1	2	1																																																																						
Prof.As.Dr	4	4	4	4																																																																						
Dr/PhD	7	5	8	5																																																																						
Msc	13	4	13	1																																																																						
Total	26	14	27	11																																																																						
Stafi akademik i programit të studimit	2019-2020		2018 – 2019																																																																							
	PAE	PAK	PAE	PAK																																																																						
Prof.Dr	4	0	2																																																																							
Prof.As.Dr	3	3	3	2																																																																						
Dr/PhD	4	5	2	3																																																																						
Msc	14	0	8	0																																																																						
Total	25	8	15	5																																																																						




	<p>U vu re gjithashtu se personeli akademik në program merr pjesë në projekte shkencore, realizon kërkime shkencore dhe ka botime në konferenca dhe revista shkencore të fushave përkatëse (ekonomi dhe inxhinieri kompjuterike).</p> <p>Evidenca: <i>Aneks Tabela Permbledhese Informatike Ekonomike.pdf Referencë: Tabela 7 në anekset e RVB</i> <i>Evidenca 33 Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Të dhënat në DVV dhe në anekset e RVB dëshmojnë shumë marrëveshje të nënshkruara me biznese dhe institucione të ndryshme akademike, kërkimore me qëllim kryerjen e praktikave mësimore për studentët. Në tabelën 5 në anekset e RVB, listohen Institucionet me të cilat Universiteti Luarasi ka marrëveshje bashkëpunimi për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike. Evidencë u gjet edhe në DVV për marrëveshjet e bashkëpunimit dhe kryerjen e praktikave mësimore.</p> <p>GVJ, gjatë takimit me studentët, konfirmoi mënyrën e instruktimit dhe udhëheqjes së tyre gjatë procesit të përgatitjes së diplomës dhe praktikës profesionale. Në lidhje me punimin e temës së diplomës Institucioni ka një procedurë të mirëpërcaktuar të cilën e referon në rregullore dhe sipas së cilës në dispozicion të studentëve është stafi akademik që orienton dhe udhëzon këta të fundit sipas nevojës.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 17 Institucionet bashkepunuese me Luarasin.pdf</i> <i>Evidenca 18 Institucionet ku jane kryer praktikat mesimore.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Nga ana e GVJ gjatë vizitës në Institucion u vu re se orët mësimore të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin Luarasi, ofrohen në klasa të pajisura në mënyrë të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor (tabela shënimesh, projektor, poste PC në cdo sallë dhe softuerë përkatës). Gjithashtu nga shqyrtimi i të dhënave të raportuara në RVB dhe konfirmuar gjatë vizitës në Institucion, GVJ konfirmon se personeli akademik i programit të studimit punon me personel ndihmës akademik për realizimin e seminareve dhe orëve të zgjidhjes së ushtrimeve që realizohet në ambientet e universitetit. Personeli ndihmës akademik është deklaruar vazhdimisht 2 (dy) gjatë gjithë viteve akademike. Aktivitetet që kryhen nga personeli ndihmës akademik sipas konfirmimit që u krye në Institucion janë: menaxhimi i sallave të laboratoreve në funksion të mësimit dhe menaxhimi i materialeve mësimore në lëndët e programit të studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--



III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Sipas raportimit në RVB për këtë kriter, konstatohet se Institucioni ka hartuar në vitin 2019 një udhëzues strategjik pesëvjeçar për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative në mësimdhënie. Ky dokument, i miratuar nga Senati i Universitetit Luarasi paraqet në mënyrë të përmbledhur vizionin dhe strategjinë e Universitetit Luarasi për mbështetjen e zhvillimit pedagogjik dhe didaktik të stafit akademik të universitetit në periudhën 2019- 2024. Në RVB, raportohen gjithashtu module trajnimi për stafin si psh: “Learning assessment and student motivation”.pdf, dhe Moduli i trajnimit - Mësimdhënia me në qendër studentin.pdf.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 29 Udhëzues_Metodat Inovative te Mesimdhënies.pdf</i> <i>Modul trajnimi “Learning assessment and student motivation”.pdf</i> <i>Moduli i trajnimit - Mësimdhënia me në qendër studentin.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Duke shqyrtuar përmbajtjen e DVV, GVJ konstaton se nga ana e Institucionit janë implementuar disa elemente në cilësinë e mekanizmave të monitorimit për të kontrolluar aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Komisioni Ad-Hoc për Monitorimin dhe funksionimin e procesit mësimor i ngritur me urdhër të Rektorit të Universitetit Luarasi (për vitin akademik 2019 – 2020 dhe 2021 – 2022, semestri I). Fokusi i kësaj metode vlerësimi ishte monitorimi i procesit mësimor të stafit akademik të brendshëm të Universitetit Luarasi në kuadrin e përmirësimit dhe rritjen e nivelit të mësimdhënies për pedagogët asistentë lektorë me titullin Msc. Zakonsiht kjo formë monitorimi ishte e paparalajmëruar dhe fokusohet në vëzhgimin e disa elementeve në mësimdhënie, si përdorimi i mjeteve didaktive në funksion të mësimdhënies, komunikimi me klasën, tërheqja e studentëve në ndërveprim, etj. 2. Vlerësimi i pedagogëve nga kolegët e tyre nëpërmjet plotësimit të formularit përkatës të vlerësimit ku pedagogu që vlerësohet duhet t’i bëjë të njohura kolegut që e vlerëson programin e lëndës, si edhe materiale të tjera didaktike që ai përdor gjatë orës së mësimi dhe të dy së bashku duhet të bien dakord për kohën më të përshtatshme gjatë së cilës do të kryhet vëzhgimi në klasë brenda dy javëve. Pas vëzhgimit në klasë, vlerësuesi duhet t’i bëjë të njohur kolegut vlerësimin e tij. 3. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga ana e studentëve nëpërmjet “Analizës së vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies në shkollat e larta mbi bazën e metodave statistikore”. Kjo anketë u shpërndahet studentëve në fund të cdo semestri dhe mbledh vrojtime ndër të tjera edhe në lidhje me cilësinë e mësimdhënies nga ana e stafit akademik. 4. Vlerësimi nëpërmjet focus grupeve. Sikurse GVJ u vu në dijeni gjatë vizitës në Institucion, kjo metodë vlerësimi filloi të



	<p>aplikohej në Institucion para pandemisë duke u fokusuar tek vlerësimi nëpërmjet opinioneve të studentëve. Kjo formë vlerësimi pati një ndërprerje gjatë pandemisë, dhe pritet të rifillojë së shpejti zbatimin e saj.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 32.3 Raport mbi vezhgimin e pa paralajmeruar te cilesise ne metodat e mesimdhënies.pdf</i> <i>Evidenca 30.1 Format raporti me komente vleresimi Pedagogu.pdf</i> <i>Evidenca 32.5 Vleresimi i cilesise Pyetsori i studenteve.pdf</i> <i>Evidenca 32.4 Si zbatohen ne praktike syllabuset e lendeve.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimin të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Sic u përmend në kriterin 2 më lart, GVJ konstatoi se në Universitetin Luarasi studentët përbëjnë një ndër elementet që aktivizohen si mekanizma monitorimi të aftësive mësimdhënëse të personelit akademik. Në pyetësorin që studentët plotësojnë (pjesë e evidencave në DVV), atyre u kërkohet të shprehen në lidhje me karakteristika të tilla si: mësimdhënia, vlerësimi i pedagogut, vlerësimi i kurrikulës dhe këshillimi akademik. Rezultatet e vlerësimin nëpërmjet pyetësorëve të studentëve përpunohen dhe përcillen pranë Rektorit të Institucionit i cili reflekton analizën e tyre në bashkëpunim me përgjegjës të njësive kryesore dhe nëse është e nevojshme edhe me pedagogët përkatës.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 32 Manuali NJSBC.pdf</i> <i>Evidenca 32.5 Vleresimi i cilesise Pyetsori i studenteve.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimin.</p>	<p>Në RVB për këtë kriter deklarohen informacione të përgjithshme, dhe thuhet se rezultatet e vlerësimin të procesit të mësimdhënies i bëhen me dije çdo pedagogu në mënyrë konfidenciale. Kjo praktikë u konfirmua edhe nga anëtarët e stafit akademik gjatë vizitës në Institucion.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimin dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Në RVB për këtë kriter referohet se Institucioni nxit dhe inkurajon përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet trajnimeve të ndryshme, duke i përdorur rezultatet e vlerësimin si tregues për vlerësimin e performancës. Nuk hasen megjithatë evidenca për incentiva specifike apo indikatorë konkretë. Të pyetur për këtë gjatë vizitës në Institucion, stafi u shpreh se praktikave të mira të mësimdhënies inkurajohen dhe nxiten nga ana e drejtuesve në një format të përgjithshëm.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.2 Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikave të mira.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikave profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Rregullores dhe Planit Mësimor të Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin Luarasi, por edhe nga konfirmimet gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se format e mësimdhënies të miratuara nga Institucioni për këtë program studimi specifik janë leksionet, projektet, detyrat praktikave dhe seminarët si edhe orët të pavarura mësimore të realizuara nga studentët.</p> <p>Evidenca:</p>

	<p><i>Evidenca 8 Rregullore Programi.pdf</i> <i>Evidenca 11 Programi i studimit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Në RVB për këtë kriter, Institucioni nxjerr në pah përjasjen e tyre për të aplikuar metoda interaktive dhe inovative si edhe për të vendosur studentin në qendër të procesit të mësimdhënies e mësimnxënies. Format e ndryshme të vlerësimit të dijeve që aplikohen për lëndët e këtij programi studimi garantojnë vlerësimin e një larmie talentesh dhe diversiteti të mënyrave të të mësuarit të studentëve. Gjatë vizitës në Institucion dhe takimit me personelin akademik dhe me studentët, GVJ formoi përshtypjen se personeli akademik mundohet të ofronte sa më shumë raste praktike gjatë orëve mësimore dhe gjatë laboratoreve si dhe të trajtonin situata sa më aktuale në fushën e informatikës së biznesit. Sidomos pedagogët e lëndëve në fushën ekonomike u shprehën se ata përpiqeshin që të përshtasinin syllabusin dhe përmbajtjen e temave të ndryshme në funksion të formimit të studentëve të këtij programi.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Informacioni që GVJ ka marrë nga DVV dëshmon kryerjen e disa trajnimeve për personelin në lidhje me përmirësimin e kompetencave didaktike të tij si motivimi i studentëve, metoda inovative në mësimdhënie, etj. Po kështu, infrastruktura që u mundësohet pedagogëve gjatë procesit të mësimdhënies nga ana e Institucionit gjykohet se është e përshtatshme për aplikimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike.</p> <p>Në RVB për këtë kriter deklarohen disa trajnime të stafit në Institucione partnere në kuadër të marrëveshjeve të shkëmbimit Erasmus +, si edhe mbështetje institucionale për pjesëmarrje në konferenca dhe aktivitete të tjera shkencore. Vetë Institucioni organizonte në mënyrë periodike cdo vit Konferencën Shkencore të tij si edhe publikonte revistën shkencore.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 29 Udhezues_Metodat Inovative te Mesimdhënies.pdf</i> <i>Modul trajnimi "Learning assessment and student motivation".pdf</i> <i>Moduli i trajnimit - Mësimdhënia me në qendër studentin.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>GVJ konstatoi në të vërtetë gjatë diskutimeve me stafin se lektorët në Universitetin Luarasi përpiqeshin të përfshinin në klasat e tyre përdorimin e programeve profesionale, përpiqeshin të angazhonin studentët në diskutime në klasë, në debate shkencore, në prezantimet me gojë, projektet dhe esetë. Përsa i përket kompetencës së personelit akademik, studentët e programit të studimit u shprehën të kënaqur me nivelin akademik dhe aftësitë didaktike të demonstruara nga ana e pedagogëve si edhe me fleksibilitetin e tyre sidomos në kushtet e fundit të mësimdhënies online. Kompetenca e personelit akademik dëshmohej edhe nga CV të tyre që gjenden në DVV.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Sipas RVB për këtë kriter, procesi i vlerësimit të pedagogëve përfshin edhe studentët nëpërmjet pyetësorëve të cilët ata i plotësojnë në mënyrë elektronike dhe anonime në fund të cdo semestri. Në këto pyetësorë studentët kanë mundësi të shprehin opinionet e tyre për cilësinë e mësimdhënies së pedagogëve, dhe komentet e opinionet e tyre analizohen dhe shtrohen për reflektim në nivele të larta institucionale.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 30 Format raporti vleresimi Pedagogu.pdf</i> <i>Evidenca 32.5 Vleresimi i cilesise Pyetsori i studenteve.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.</p>	<p>Në RVB Institucioni konfirmon organizimin në mënyrë interaktive të orëve mësimore. Gjithashtu, GVJ në takimin me disa nga pedagogët e angazhuar në këtë program, mori informacion se ata përpiqen t'i</p>

	organizojnë studentët në grupe pune dhe i angazhojnë ata në diskutime duke i vendosur në kushte të ngjashme me situata reale në terren. Për këto arsye GVJ e konsideron të përmbushur këtë kriter.			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Mbështetur në përshtypjet e krijuara nga diskutimi me studentët e programit të studimit bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin Luarasi, GVJ është e mendimit se format e mësimdhënies të zbatuara nga pedagogët e Institucionit janë efektive dhe eficiente për të nxitur një frymë të shëndetshme reflektimi dhe debati gjatë orëve mësimore. Personeli akademik përpiquej të krijonte kushtet që studentët të reflektojnë gjatë mësimdhënies, duke i caktuar secilit përgjegjësi të qarta për detyra specifike duke i nxitur kështu që të fitojnë aftësi shprehëse dhe argumentuese edhe në diskutimet me njëri tjetrin. Në përgjithësi GVJ formoi opinionin se kjo metodë mësimdhënie, inkurajon të menduarin e pavarur dhe kritik nga ana e studentëve si edhe i bën ata më të hapur dhe të aftë të artikulojnë lirisht opinionet e tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Pas shqyrtimit të DVV dhe sidomos gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se Universiteti Luarasi ofron mjedise me infrastrukturën e nevojshme, (ndricim, sistem kondicionimi, ujë, sistem wireless, bibliotekë për të lexuar apo studiuar dhe laboratorë kompjuterikë) për të realizuar procesin mësimor. Këtu nuk bën përjashtim as programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike. Ambientet, si korridoret dhe ambientet e tjera të përbashkëta, ishin të monitoruara me sistem kamera për të garantuar sigurinë e studentëve dhe stafit.
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Në Universitetin Luarasi klasat janë të pajisura me mjetet e nevojshme për të bërë funksional në tërësi procesin mësimor, si kompjutera, projektorë, tabela, etj. Kompjuterët në klasë dhe kompjuterët e vendosur në laboratorë përmbanin softuerët e nevojshëm, programet dhe paketat softuerike të kërkuara për lëndë specifike të këtij programi studimi sikurse dëshmojnë evidencat në DVV dhe që u konstatuan edhe gjatë vizitës në Institucion. Në RVB jepen detaje në lidhje me laboratorët që janë në dispozicion për t'u shfrytëzuar nga studentet e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin Luarasi - gjithsej 3 laboratorë kompjuterikë, një për leksione dhe dy për seminare. Evidenca: <i>Evidenca 34.1 Infrastuktura IT.pdf</i>
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të	Në ambientet e Institucionit u verifikua se funksionon rrjeti wireless ku ka akses cdo student, personeli akademik dhe guest. Institucioni aplikon platformën MOODLE LMS për menaxhimin e procesit mësimor dhe studentët e stafi kanë akses në këtë platformë edhe nga jashtë godinave të kampusit. Përtej saj, strukturat menaxheriale të Institucionit përdorin

<p>nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>platformën e menaxhimit të ngarkesës mësimore të pedagogëve ndërsa për menaxhimin e fondit të bibliotekës përdoret një aplikacion i vecantë për menaxhimin e titujve. Paketat softuerike të përdorura për qëllime të mësimdhënies janë Windows, MS Office, Adobe Reader, të mundësuar në platformën LMS.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 20 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it-Moodle tutorial.pdf</i> <i>Evidenca 34.1 Infrastruktura IT.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programeve lëndore, si edhe listës së literaturës në funksion të programit të studimit, GVJ konstatoi se në pothuajse të gjitha lëndët ofrohen tituj të larmishëm në literaturë (të detyrueshëm dhe të sugjeruar) në dispozicion të studentëve. Tekstet janë në përgjithësi prestigjioze dhe tituj të respektuar në fushat përkatëse. Sugjerimi i GVJ është vetëm përditësimi i tyre me botime të viteve më të fundit, në disa prej lëndëve që ende nuk e kishin bërë një përditësim të tillë, duke qenë se ekziston mundësia për një gjë të tillë, si dhe shtimi i titujve në gjuhën shqipe. GVJ gjykon se përbërja e titujve të literaturës garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 21 Lista e literatures ne funksion te programit te studimit;.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Konfirmimi i literaturës fizike në bibliotekën e Universitetit Luarasi nga ana e GVJ mbështet konstatimin e bërë në kriterin 4 më lart se titujt e vënë në dispozicion të studentëve ofrojnë dije dhe informacion të pasur për studentët në këtë program studimi.</p> <p>Materialet e bibliotekës mund të përdoren ose në mjedisin e bibliotekës, ose mund të huazohen për përdorim të jashtëm në bazë të kërkesave apo prenotimeve të studentëve sic u specifikua nga stafi që punonte aty. Vetë biblioteka e kampusit përdor një sistem informacioni të menaxhimit online, dhe që mundëson menaxhimin e burimeve në bibliotekë dhe hyrjen e daljen e titujve të ndryshëm.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Sipas RVB për këtë kriter nuk kuptohet qartë nëse Universiteti Luarasi ofron ose jo akses për studentët dhe stafin akademik në ndonjë nga bibliotekat online. GVJ pyeti gjatë vizitës në Institucion dhe u informua se për stafin akademik dhe studentët ka akses në fondet online të bibliotekave të mundësuar nga Rrjeti Akademik Shqiptar.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Në RVB specifikohet se e gjithë infrastruktura laboratorike në Universitetin Luarasi është në dispozicion të vazhdueshëm të studentëve të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike. Të pyetur në lidhje me qasjen e tyre në laboratorë, studentët e programit të studimit u shprehën konfidentë se kanë liri të shfrytëzojnë burimet e institucionit në laboratorë si edhe në klasa, për të përgatitur dhe prezantuar detyrat e kursit.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>GVJ, bazuar në shqyrtimin e DVV, si edhe RVB konstaton se Universiteti Luarasi përdor dy platforma të rëndësishme në funksion të mësimdhënies.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Platforma Learning Management System (LMS) me bazë në Moodle për koordinimin dhe organizimin e lëndëve online dhe për mirëmbajtjen e burimeve për çdo lëndë. Kjo platformë është efektive që nga viti akademik 2018 – 2019. • Sistemi i Menaxhimit të Burimit të Bibliotekave që është një sistem i integruar i bibliotekave.

	Evidenca: <i>Evidenca 20 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it-Moodle tutorial.pdf</i>			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Sipas RVB Universiteti Luarasi i ka pajisur studentët me llogari në Microsoft Office 365, të cilat shërbejnë si mënyrë komunikimi mes studentëve dhe pedagogëve. Këto llogari vetiake të studentëve kanë hapësira memorje për të ruajtur materialet e nevojshme për procesin mësimor. Ky sistem u konstatua se përdoret edhe për studentët e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike. Vec llogari vetjake në Microsoft, Institucioni, sic u përmend edhe më lart shfrytëzon sistemin LMS Moodle për menaxhimin e proceseve të tjera mësimore. Përtej thjesht procesit mësimor, Universiteti Luarasi shfrytëzon platformën Microsoft Sharepoint si një instrument për të digjitalizuar arkivën e dokumentacionit të brendshëm. Sic deklarohet në RVB për këtë kriter që nga viti akademik 2019 – 2020 në këtë platformë ka edhe një skedar të dedikuar vetëm për studentët. Nga intervistat e zhvilluara me personelin akademik dhe me studentët u mësua se sistemi LMS Moodle ishte gjerësisht i përdorur nga të dyja palët për të mirë koordinuar hapat gjatë semestrit, si materialet mësimore, vlerësimet gjatë vitit dhe ato përfundimtare, etj.			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Sipas Rregullores së programit të studimit GVJ konstatoi se studentët e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin Luarasi të cilët kanë një mesatare jo më pak se nota 8 (tetë) dhe duke ndjekur edhe kufijtë e vendosur nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit kanë të drejtë të diplomohen nëpërmjet përgatitjes së punimit të diplomës. Ky është një punim në formën e një projekti ose përmbledhje punimesh të kryera në fushat e programit të studimit. Tema e punimit të diplomës përgatitet në semestrin e gjashtë dhe të fundit të studimeve dhe Institucioni hap tre sezona diplomimi në vit. Neni 18, pika 5 e Rregullores së programit të studimit specifikon se studenti drejtohet nga një udhëheqës i miratuar i cili orienton studentin përsa i përket afateve, strukturës dhe përmbajtjes së punimit. Ky udhëheqës rishikon punën finale të studentit dhe jep lejen e tij përpara mbrojtjes së punimit të diplomës. GVJ konstatoi edhe se Institucioni ka përgatitur një udhëzues për përgatitjen e temës së diplomës. Kjo praktikë u konfirmua edhe nga studentët gjatë vizitës në Institucion. Evidenca: <i>Evidenca 8 Rregullore Programi.pdf</i> <i>Evidenca 22 Rregullore e diplomimit.pdf</i> <i>Evidenca 22.1 Udhëzuesi i shkrimit të diplomes.pdf</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4


Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies,	Nga çfarë konfirmon në DVV, GVJ konstaton ngritjen një strukture të posaçme për promovimin dhe monitorimin e cilësisë së mësimdhënies. Kjo strukturë e njohur si NJBSC – Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë bashkëpunon me njësitë kryesore dhe njësitë bazë për të

<p>koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>përmirësuar vazhdimisht cilësinë e mësimdhënies. Sipas Manualit të NJBSC, përgjegjës për garantimin e cilësisë në nivel institucional janë strukturat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Senati i universitetit • Rektori • Njesia e Brendshme e Sigurimit të Cilesise (NJBSC) • GVB • Studentët, stafi. <p>Strategjia e NJBSC konfirmon orientimin e Institucionit drejt një niveli të lartë të cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 32 Manuali NJSBC.pdf</i> <i>Evidenca 32.1 Strategjia e NJBSC.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Sipas Rregullores së Fakultetit, GVJ konstaton se departamenti është njësia bazë përgjegjëse për programet e studimit që ofron. Përgjegjësi i departamentit ndër funksionet që ka, duhet edhe të mbikëqyrë veprimtarinë shkencore në departament, të mbikëqyrë respektimin e programeve të mësimdhënies, dhe veprimtarive të tjera të procesit mësimor dhe organizon analiza periodike vjetore të procesit të mësimdhënies.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 7 Rregullore Fakulteti.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Referuar RVB të përgatitur nga Institucioni në këtë kriter shihet se Universiteti Luarasi ka orientim të theksuar drejt analizës së punës mësimore të stafit akademik duke organizuar herë pas here mbledhje ku shkëmbehen ide të ndryshme për mënyrat e mësimdhënies. Të pyetur për këto qasje, kjo u konfirmua edhe nga stafi akademik gjatë vizitës, të cilët u shprehën se ndjehen të mbështetur nga Institucioni që të implementojnë metoda inovative të mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Nga shqyrtimi i materialeve të dorëzuara si pjesë e DVV, konstatohet nga ana e GVJ se personeli akademik i është nënshtruar të paktën një kualifikimi në fushën e përgatitjes dhe publikimit të artikujve shkencorë. Ky trajnim është kryer në shkurt të vitit 2019. Por në vizitën në institucion, GVJ mori informacion edhe për trajnime të tjera në vazhdimësi të kryera me stafin akademik.</p> <p>Evidenca: <i>Moduli i trajnimit - How to write and to publish an academic paper.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion dhe takimeve me stafin GVJ mësoi se ata angazhohen në mënyrë periodike në trajnime të ndryshme. Megjithatë trajnimi i fundit i stafit për mësimdhënien me në qendër studentin, sic raportohet në dokumentacionin e DVV, është në tetor të vitit 2019. Gjatë vizitës në institucion, GVJ mori informacion edhe për trajnime të tjera në vazhdimësi të kryera me stafin akademik.</p> <p>Evidenca: <i>Moduli i trajnimit - Mësimdhënia me në qendër studentin.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua gjatë diskutimeve me personelin akademik efektiv të angazhuar me këtë program studimi, se ata janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit sikurse parashikohet edhe në Rregulloren e Fakultetit, neni 8 ku përshkruhen detyrimet dhe përgjegjësitë e personelit akademik. GVJ krijoi përshtypjen se stafi i angazhuar në këtë program demonstroi</p>

mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	përkushtim për të përmirësuar vazhdimisht cilësinë e tyre të mësimdhënies.		
	Evidenca: <i>Evidenca 7 Rregullore Fakulteti.pdf</i>		
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Në RVB të Institucionit specifikohet se lektorët e lëndëve nxiten të zbatojnë metoda të reja mësimore në lëndët e tyre përkatëse dhe i ndajnë eksperiencat e tyre dhe çfarë kanë mësuar gjatë mbledhjeve periodike të stafit. Evidenca 35 paraqet një procesverbal nga një mbledhje e zakonshme e stafit akademik.		
	Evidenca: <i>Evidenca 35 Format Mbledhje Departamenti.pdf</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X

Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstatoi se mënyra e testimit të njohurive të studentëve përcaktohet në Rregulloren e Universitetit Luarasi, Rregulloren e Programit të Studimit si edhe është pjesë e programeve lëndore. Rregullorja e Universitetit është e publikuar në faqen e internetit të Institucionit dhe sic u verifikua edhe nga GVJ gjatë vizitës në Institucion, studentët kanë njohuri të kënaqshme mbi këto rregullore. Një faktor që kontribuon në shkallën e njohjes së kriterëve dhe mënyrave të testimit e vlerësimit të njohurive dhe dijeve nga ana e studentëve është se elemente të tyre përfshihen në syllabuse të lëndëve mësimore dhe diskutohen në javën e parë të cdo semestri akademik. Evidenca: <i>Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Luarasi.pdf</i> <i>Evidenca 8 Rregullore Programi.pdf</i> <i>Syllabus IE Viti III 21-22.pdf</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga diskutimi me studentët e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin Luarasi, GVJ konstatoi se ata njihen në fillim të çdo lëndë/moduli me Objektivat e lëndës, Rezultatet e Mësimit të lëndës dhe Metodën e Vlerësimit të lëndës nga titullari i lëndës/modulit. Këto elemente janë pjesë e programeve lëndore të cilat vendosen në dispozicion të studentëve qysh në fillim të semestrit.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Nga shqyrtimi i programeve lëndore të disiplinave të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin Luarasi u vërejt se në to ka elemente të larmishme të kontrollit dhe vlerësimit të njohurive të studentëve. Këto elemente janë: <ul style="list-style-type: none"> • provimet dhe testimet e ndërmjetme (pas javës së 7 të mësimit) dhe përfundimtare (pas javës së 15), • detyrat e kursit, • niveli i aktivizimit në seminare apo punë laboratorike,



	<p>Shpërndarja e komponentëve të vlerësimit gjatë gjithë vitit / semestrit ul riskun e varësisë së vlerësimit final të studentit nga rrethana specifike kohore që shpesh janë jashtë ndikimit të studentit apo të Institucionit dhe nuk reflektojnë ecurinë dhe angazhimin real të studentëve në procesin mësimor.</p> <p>Evidenca: Sylabus IE Viti III 21-22.pdf</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Sikurse jemi shprehur edhe më lart në këtë raport, GVJ ka konstatuar nga analiza e dokumentacionit në DVV, se vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit në programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm gjatë gjithë periudhës mësimore dhe vitit akademik dhe është rezultante e disa elementeve të shtrira gjatë gjithë vitit akademik (Tabela 15 në shtojcat e DVV prezanton këto elemente vlerësimi të vazhdueshëm gjatë vitit akademik)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive 10% • Plotësimi i detyrimeve (lab/detyra kursi) 20% • Testimet gjatë vitit 30 % • Provimi përfundimtar 40% • Totali 100% <p>GVJ gjykon se përfshirja e një larmie të formave të vlerësimit u jep mundësinë të gjithë studentëve të shprehin njohuritë dhe kompetencat e fituara në njërin ose disa prej formave të zgjedhura të testimit.</p> <p>Evidenca: Aneks Tabela Permbledhese Informatike Ekonomike.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Në RVB për këtë kriter Institucioni deklaron se përdoren kryesisht metoda fizike të testimit dhe vlerësimit, me përjashtim të dorëzimit të detyrave të kursit dhe eseve përkatëse. Në kushtet e mësimin online sigurisht që janë praktikuar metoda elektronike vlerësimi të studentëve (platforma Teams e Microsoft), sikurse konfirmohet edhe nga pedagogët e programit të studimit gjatë intervistave me ta. Në RVB deklarohet se që nga vitit akademik 2019 – 2020 është planifikuar implementimi i metodave Clean Score në një pjesë të lëndëve të programit të studimit, proces i cili pati një ndërprerje për shkak të periudhës së pandemisë. Megjithatë, GVJ e gjykon të përmbushur këtë kriter pasi platformat mësimore online (psh., Teams që vazhdojnë të përdoren nga institucioni edhe pas përfundimit të periudhës së pandemisë) eliminojnë mundësinë e formave të abuzimit duke rritur transparencën e vlerësimit të studentëve.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në RVB për këtë kriter deklarohet si referencë neni 15 i rregullores së programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin Luarasi dhe thuhet se në të gjitha rastet që aplikohet testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale kjo realizohet nga komisionet e provimeve ku njëri është titullari i lëndës dhe pedagogu tjetër është pedagog i një lënde të përafërt. Komisionet e provimeve me dy anëtarë u konfirmuan nga GVJ edhe nga kontrolli i procesverbaleve të</p>

	<p>provimeve të kryera pranë sekretarisë mësimore gjatë vizitës në Institucion.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 8 Rregullore Programi.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Në RVB për këtë kriter deklarohet si referencë neni 15 i rregullores së programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin Luarasi dhe thuhet se në të gjitha rastet aplikohet kodimi i testeve ndërmjetëse dhe finale nga punonjësit e sekretarisë mësimore. Testet dekodohen pas vlerësimit në mënyrë anonime nga pedagogët. Kjo procedurë menaxhohet nga sekretaria e institucionit dhe u konfirmua në mungesë të pavarur edhe nga stafi akademik, por edhe nga personeli i sekretarisë mësimore.</p>			
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Sipas RVB në lidhje me këtë kriter gjejmë dhënien e informacionit të mëposhtëm: “Vlerësimi i të gjithë komponentëve të vlerësimit shoqërohet me feedback dhe komente të detajuara nga ana e pedagogëve. Pas zhvillimit të testimit të ndërmjetëm dhe atij final zhvillohet një seancë sqaruese me studentët ku këta të fundit ballafaqohen me vlerësimin dhe cilësinë e punës së tyre. Kjo procedurë u konfirmua nga stafi akademik si edhe nga studentët e programit të studimit, edhe për provimet e ndërmjetme, edhe për provimet finale të fundit.</p>			
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>RVB për këtë kriter shprehet se Institucioni nëpërmjet njësive përgjegjëse dhe personelit akademik shmangin plagjiaturën duke caktuar dy pedagogë në administrimin e çdo provimi. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, stafi u shpreh se plagjiatura nuk tolerohet dhe se ata përpunonin të gjithë studentët me integritet tek studentët.</p>			
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>RVB për këtë kriter shprehet se ka një periudhë kohore prej deri në dy javë për dhënien e rezultateve të testeve. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, stafi akademik u shpreh se ata angazhohen që të jenë të hapur dhe të drejtpërdrejtë me studentët duke i nxitur që të angazhohen sa më shumë në procesin e mësimin në mënyrë që vlerësimet e dhëna për ta të jenë me meritë dhe të reflektojnë me transparencë përgatitjen e vërtetë të studentëve.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>RVB për këtë kriter shprehet se zhvillohet një seancë sqaruese me studentët të cilët mund të njihen me vlerësimin e tyre. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, kjo procedurë konfirmohet nga stafi akademik të cilët u shprehën se studentët mund të rishikonin vlerësimin e tyre si për provimin përfundimtar ashtu edhe për provimet e ndërmjetme nëse lënda kishte të tilla.</p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>RVB për këtë kriter shprehet për një komision me dy pedagogë të cilët së bashku me përgjegjësin e departamentit të njësive kryesore rishqyrtojnë vlerësimin e testit. Pra, nëse edhe pas rishikimit me pedagogët e lëndës, studenti nuk bindet për vlerësimin e marrë, gëzon të drejtën që kërkesa e tij të shqyrtohet nga një komision i posaçëm që përgjegjësi i departamentit ngre për këtë qëllim.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentëve, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programeve lëndore, GVJ konstaton se realizimi dhe zhvillimi i programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin Luarasi mundësohet nga një kombinim i ekuilibruar i mënyrave të ndryshme të mësimdhënies si shembuj dhe punë në laborator për lëndët e fushës së informatikës; pyetje dhe analizë kritike për problem-zgjidhje; raste studimore; etj. Kombinimi i këtyre elementeve u jep mundësi studentëve të programit të zhvillojnë aftësitë profesionale dhe të thellojnë njohuritë e marra.</p> <p>Evidenca: <i>Sylabus IE Viti II 20-21.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor dhe i syllabuseve të Programit të Studimit, GVJ konstaton se dhënë specifiken e fushës së tij, ky program mundëson thellimin e njohurive në mënyrë të përgjithshme dhe specifike në fushën e teknologjisë së informacionit. Gjithashtu, plani mësimor përmban lëndë të gjuhës së huaj angleze, lëndë që fokusohen në menaxhim dhe histori ekonomike duke dhënë, sipas gjykimit të GVJ, një sfond të nevojshëm që nxit të menduarin e integruar multidisiplinar tek studentët, komunikimin dhe ndërveprimin mes tyre.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 11 Programi i studimit.pdf</i> <i>Sylabus IE Viti II 20-21.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>GVJ konstatoi se programet lëndore të Programit të Studimit, Bachelor në Informatikë Ekonomike, kanë të përfshira një element të rëndësishëm i cili është “Rezultatet e të nxënësve nga studentët”, (kjo në përputhje edhe me kërkesat e VKM nr.41), por sugjerojmë që në këtë seksion të jenë më të qarta dhe të detajuara njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që fiton studenti në përfundim të lëndës. Gjithashtu, në pasqyrën e temave të trajtuara sipas javëve të semestrit bie në sy se në javën e 15 zakonisht bëhet një përmbledhje e programit të trajtuar semestral. Nga konfirmimet që GVJ bëri gjatë vizitës në Institucion në përfundim të semestrit, para provimit pothuaj të gjithë pedagogët kishin si praktikë pune të bënë një përmbledhje të lëndës ku paraqesin rëndësinë e cdo njohurie të marrë gjatë semestrit dhe lidhjen e tyre me rezultatet e të nxënësve.</p> <p>Evidenca: <i>Sylabus IE Viti II 20-21.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të RVB, GVJ konstatoi se Institucioni garanton angazhimin e personelit akademik në realizimin e orëve të hapura dhe seminareve ku merrnin pjesë jo vetëm studentët e programit të studimit por edhe studentët dhe pedagogë nga programe të tjera. Megjithatë GVJ gjykon se referenca e dhënë për këtë qëllim “Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik” nuk ka lidhje me plotësimin e këtij kriteri.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 33 Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin Luarasi është i fokusuar në lëndë të profilit të teknologjisë së informacionit dhe është i kompletuar me praktikë profesionale. E cila paraqitet si një lëndë e detyrueshme e cila zhvillohet në semestrin e gjashtë. Ajo mundëson që studentët të arrijnë të zhvillojnë gjatë</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin Luarasi është i fokusuar në lëndë të profilit të teknologjisë së informacionit dhe është i kompletuar me praktikë profesionale. E cila paraqitet si një lëndë e detyrueshme e cila zhvillohet në semestrin e gjashtë. Ajo mundëson që studentët të arrijnë të zhvillojnë gjatë</p>

	praktikës njohuritë e marra në vitet e studimeve të tyre. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ pati mundësinë të konfirmojë kryerjen e praktikave profesionale nga ana e studentëve.			
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Në RVB të përgatitur nga Institucioni për këtë kriter deklarohet se metodat e mësimdhënies të përdorura nga personeli akademik përfshijnë projekte në grup dhe diskutime të krijuara për të zhvilluar aftësi të të menduarit kritik dhe për të edukuar studentët me mendësinë e punës në grup për zgjidhjen e problemeve. Kjo mënyrë e organizimit të orëve mësimore dhe procesin e të mësuarit, u konfirmua gjatë vizitës në Institucion edhe nga stafi akademik, por edhe nga studentët që ndjeheshin të lirshëm dhe të trajtuar në mënyrë inkurajuese nga pedagogët.			
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Nga intervistat me personelin akademik të Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se ata shprehen në favor të krijimit të një klime të përshtatshme bashkëpunimi në klasë. Përsa i përket statistikave konkrete, në tabelën 22 në anekset e RVB vihet re se për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike deklarohen 3 studentë të aktivizuar për punime shkencore individuale të pedagogëve, dhe 6 studentë të angazhuar në projekte shkencore në nivel fakulteti.			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Evidenca: <i>Aneks Tabela Permbledhese Informatike Ekonomike.pdf</i>			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Nga shqyrtimi i listës së marrëveshjeve të bashkëpunimit për institucionin dhe programin e studimit, si edhe gjatë diskutimeve në Institucion, GVJ vëren se një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh në fushën e kërkimit shkencor dhe shkëmbimit të stafit akademik dhe të studentëve. Për këtë program studimi, nga tabela 20 në shtojcat e RVB vihet re se ka pasur një pjesëmarrje në konferenca kombëtare ose ndërkombëtare dhe tre pjesëmarrje në aktivitete shkencore jashtë IAL / jashtë vendit. Nuk ka pasur mobilitete shkëmbimi Erasmus pwr studentwt. Evidenca: <i>Evidenca 14 Marreveshjet Erasmus tabela.pdf</i> <i>Aneks Tabela Permbledhese Informatike Ekonomike.pdf</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në DVV, GVJ konstaton se për procesin e diplomimit studentët e Programit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin Luarasi, i nënshtrohen ose një provimi të përgjithshëm, ose përgatisin një punim diplome. Studentët të cilët kanë një mesatare jo më të ulët se nota 8 (tetë) i nënshtrohen procedurave të ndryshme që cojnë në diplomim, në krahasim me studentët të cilët kanë një mesatare më të ulët. Procedurat e diplomimit



	<p>specifikohen qartë dhe në mënyrë transparente në Rregulloren e Diplomimit.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 22 Rregullore e diplomimit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Në Rregulloren e diplomimit, shpjegohet në mënyrë të detajuar procedura e ndjekur për diplomimin në programin Bachelor në Informatikë Ekonomike, qoftë për studentët që i nënshtrohen një provimi të përgjithshëm gjithëpërfshirës, qoftë për studentët të cilët përgatisin një temë diplome. Punimi i diplomës është individual. Procedura parashikon asistencë nga pedagogët, udhëzime të qarta për studentët dhe materiale ndihmëse në funksion të këtij procesi.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 22 Rregullore e diplomimit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Sipas nenit 6 në Rregulloren e Diplomimit, teza e provimit përfundimtar hartohet me pyetje nga disiplinat formuese dhe karakterizuese të programit të studimit. Lista përfundimtare e pyetjeve hartohet nga dekani së bashku me përgjegjësit e njëjësive bazë përkatëse. Kjo listë dorëzohet në sekretarinë e Fakultetit dhe u vihet në dispozicion studentëve 30 ditë para provimit. Dekani ngre komision për realizimin e provimit dhe për vlerësimin me notë të studentëve.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 22 Rregullore e diplomimit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.</p>	<p>Sipas RVB për këtë kriter dhe e konfirmuar edhe gjatë vizitës në Institucion studentët ishin të asistuar në përgjithësi nga Institucioni dhe nga personeli akademik gjatë gjithë procesit të diplomimit, edhe kur i nënshtroheshin një provimi të përgjithshëm, në lidhje me strukturën dhe përmbajtjen e testimit por edhe nëse përgatishnin një punim diplome, rast në të cilin cdo studenti i caktohej detyrimisht një pedagog mbikëqyrës që e ndiqte vazhdimisht ecurinë e tij.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Institucioni kishte vendosur në dispozicion, jo vetëm pedagogët mbikëqyrës, por në varësi të nevojës së studentëve edhe lehtësira infrastrukturore, si psh aksesin në bibliotekë online apo nw bazat e tw dhwnave qw shfrytwzohen pwr kwrkim.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Sipas rregullores së diplomimit, udhëheqësi i diplomës asiston studentin që në fazat e para të përgatitjes së punimit të diplomës, përgatitjen e planit të punës, përzgjedhjen e fushës së studimit, aplikimin e metodologjisë, analizën e të dhënave etj. Punimi i diplomës paraqitet para komisioni përkatës vetëm pas miratimit nga ana e udhëheqësit të temës së diplomës. Një pedagog në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit ka të drejtë të udhëheqë deri në 5 studentë gjatë një sezoni të caktuar. Sipas nenit 10 të rregullores së diplomimit, punimi i diplomës duhet të miratohet edhe nga përgjegjësi i njësisë bazë, para se të lejohet për t'u prezantuar dhe mbrojtur para Komisionit të Vlerësimit.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 22 Rregullore e diplomimit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Sipas rregullores së diplomimit, neni 6, pika 7, provimi i përgjithshëm i diplomimit vlerësohet me notë dhe rezultati shpallet publikisht nga Kryetari i Komisionit të Vlerësimit. Studenti ka të drejtë të ballafaqohet me korrigjimin e provimit dhe nëse konstatohet ndonjë gabim në vlerësim bëhet ndryshimi i këtij të fundit. Po kështu edhe tema e</p>




	<p>diplomës vlerësohet me notë, nga 4 – 10, e llogaritur si mesatare e vlerësimit të cdo anëtari të komisionit dhe duke marrë në konsideratë vlerësimin me shkrim të udhëheqësit dhe oponentit të punimit (neni 10 i rregullores). Nota më e ulët kaluese është nota 5. Nëse studenti nuk e kalon punimin e diplomës, ai mund të mbrojë sërish të njëjtin punim, ose të mbrojë një punim të ri por jo më herët se sezoni i radhës i diplomimit.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 22 Rregullore e diplomimit.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Neni 11 i rregullores së diplomimit, parashikon pajisjen me diplomë dhe suplementin e diplomës në përfundim të procedurës së mbrojtjes së punimit të diplomës ose provimit të përgjithshëm. Suplementi i Diplomës është bazuar mbi modelin e hartuar nga Komisioni Europian, Këshilli i Europës dhe UNESCO/CEPES.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 22 Rregullore e diplomimit.pdf</i> <i>Evidenca 22.2 Model Diplome.pdf</i> <i>Evidenca 22.3 Suplement Diplome.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në RVB të dorëzuar nga Institucioni specifikohet se me kërkesën e studentit ai mund të pajiset me një kopje të plotë zyrtare të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, pra ky kriter konsiderohet i plotësuar.</p>			
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion GVJ konfirmoi se Institucioni ruante të dhënat për studentët në format hard copy. GVJ kontrolloi me zgjedhje dosjet e dy studentëve në Sekretarinë Mësimore dhe konfirmon se Institucioni ka ruajtur kopje të dokumentacionit të studentit si formulari i regjistrimit, ecuria e studentëve, dhe të dhëna të tjera të mëparshme gjatë studimeve të tij.</p> <p>GVJ kontrolloi me zgjedhje edhe regjistra të notave duke konfirmuar procedura të rregullta edhe të kujdesshme të ndjekura nga Sekretaria mësimore e Institucionit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore (ZBNJ) në Universitetin Luarasi (UL) është përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të institucionit. Duke u mbështetur tek Rregullore e UL Neni 101 pika f, si dhe tek informacionet e marra gjatë takimit me përfaqësues të ZBNJ, GVJ konstaton se ZBNJ mban dokumentacion e plotë e të rregullt për dosjen e personelit akademik dhe ndihmës administrativ. Të dhënat mblidhen dhe administrohen në përputhje me kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015. Këto të dhëna mbahen në dosje personale në format të printuar. GVJ u njoh me disa nga dosjet e protokolluara për PAE dhe PAK, që u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme. Këto dosje përmbanin dokumentat e plota të personelit në përputhje me Evidencën 36 për formatin e dosjes personale të stafit, të tilla si: kontrata e punës; deklarata e konfidencialitetit; deklarata e punëdhënësit; aneks i detajuar për aktivitetin akademik dhe kërkimor; CV; diplomat; çertifikatat e gjuhëve të huaja; etj. ZBNJ përditëson dokumentacionin në dosjet personale të stafit në mënyrë periodike, çdo vit të ri akademik, ose sipas rastit nëse ka ndryshime gradash apo titujsh akademik ose ndryshime të të dhënave personale për ndonjërin prej tyre. Këto të fundit bëhen në përputhje me Rregulloren për ZBNJ të UL Neni 30.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Luarasi.pdf</i> <i>Evidenca 36 Formatin e Dosjes personale të stafit.pdf</i> <i>Evidenca 37 Rregullore e zyres së burimeve njerëzore.pdf</i> <i>Minutat, Bsc Informatike Ekonomike.pdf</i> https://luarasi-univ.edu.al/rreth-nesh/organigrama-2/</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, GVJ konstaton se UL ka hartuar procedura për rekrutimin e personelit akademik në përputhje me kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, dhe i ka përcaktuar ato në dokumentat e brendshme të institucionit. Këto procedura janë të përcaktuara në Statutin e UL Neni 40, sipas të cilit punësimi realizohet me procedurë të konkurimit të hapur publik, në një proces transparent dhe të paanshëm. Kriteret e përgjithshme për punësimin e personelit akademik janë të përcaktuara në Rregulloren e UL Neni 27. Mbi bazën e kërkesës së drejtuesit të njësisë bazë, bazuar tek nevojat e kësaj të fundit për plotësimin e vendeve të lira të punës, dekani i fakultetit realizon procedurën e shpalljes së vendeve të lira dhe krijon komisionin ad hoc për ndjekjen e të gjithë procedurës së rekrutimit. Në përfundim dekani bën vlerësimin përfundimtar të procedurës së ndjekur, dhe i paraqet rektorit listën e kandidatëve fitues të cilët ftohen për nënshkrimin e kontratës së punës.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Procedurat për shpalljen e vendeve vakante dhe rekrutimin e personelit ndiqen nga Zyra e Burimeve Njerëzore të përcaktuara këto në Rregulloren e ZBNJ Neni 19, dhe në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UL. ZBNJ bën publike në faqen e web-it të UL njoftimet për vendet e lira të punës, të cilat përmbajnë përshkrimin e vendit të punës, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta që duhet të plotësojnë</p>




	<p>kandidatët, dokumentacionin e kërkuar dhe informacione të zyrës ku do të drejtohen aplikantët.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Luarasi.pdf</i> <i>Evidenca 37 Rregullore e zyres se burimeve njerezore.pdf</i> <i>Evidenca 6 Statuti Universiteti Luarasi.pdf</i> https://luarasi-univ.edu.al/wp-content/uploads/2022/02/PB-Financ-Banke-ose-Administrim-Biznesi.pdf</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh me procedurat për shpalljen e vendeve vakante dhe rekrutimin e personelit akademik nëpërmjet përfaqësuesit të Zyrës së Burimeve Njerezore si dhe në takimin me personelin dhe drejtuesit e institucionit, dhe konstatoi se këto procedura janë të hapura dhe transparente.</p> <p>Për programin e studimit bachelor në Informatikë Ekonomike, GVJ u informua që kërkesat për personel akademik vijnë nga Departamenti i Informatikës Ekonomike bazuar tek planet mësimore dhe ngarkesa mësimore, miratohen nga Dekani i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit dhe aprovohen nga Rektori. Kriteret specifike për personelin akademik për këtë program studimi kanë bazë kualifikimet akademike dhe eksperiencën e punës në përputhje me kërkesat e pozicionit vakant dhe fushën specifike sipas lëndëve të programit të studimit. Përzgjedhja e kandidatëve nëpërmjet vlerësimit të dosjeve të aplikimit bëhet nga një komision i përbërë nga Dekani, Përgjegjësi i departamentit dhe Administratori i UL. Përfaqësuesi i ZBNJ ndjek procedurën dhe harton relacionin përkatës që i drejtohet Rektorit dhe Senatit Akademik. Komisioni analizon përshtatshmërinë e aplikantëve me vendet e shpallura vakante dhe vendimin e miratuar ja paraqet për aprovim Senatit. Vendimi i Senatit i dërgohet për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit.</p> <p>Njoftimet për vendet vakante gjenden edhe në faqen e web-it të institucionit: https://luarasi-univ.edu.al/zyra-e-burimeve-njerezore/. Këto njoftime përmbajnë kërkesat e përgjithëshme dhe specifike, përkatëse sipas vendeve vakante të shpallura.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Luarasi.pdf</i> <i>Evidenca 37 Rregullore e zyres se burimeve njerezore.pdf</i> https://luarasi-univ.edu.al/njoftim-per-vende-te-lira-pune-per-personel-akademik-me-kohe-te-plote-ne-fakultetin-ekonomik-universitetit-luarasi-per-vitin-akademik-2021-2022-4/</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për</p>	<p>GVJ u njoh me mjediset dhe kushtet e punës për personelin akademik dhe administrativ në UL. GVJ konstatoi se këto mjedise ofrojnë kushte shumë të mira për të zhvilluar të gjitha proceset akademike dhe administrative, për përmbushjen me sukses të objektivave të procesit</p>




<p>kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>mësimor në tërësi. Të gjitha mjediset që lidhen me procesin mësimor janë të pajisura me mjete të teknologjisë së informacionit (kompjutera, projektorë, etj.) si dhe mbulohen nga rrjeti wi-fi që ofron internet për stafin dhe studentët.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 34 Infrastruktura.pdf</i> <i>Evidenca 34.1 Infrastruktura IT.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Ndër objektivat strategjike të përcaktuara në Startegjinë e Zhvillimit të Institucionit 2016-2020, UL rendiste rritjen e cilësisë dhe performancës akademike, që synohej të arrihej duke vlerësuar dhe mbështetur risitë në metodat e mësimdhënies dhe duke promovuar kontributet e secilit pedagog në lidhje me to. Gjithashtu një objektiv tjetër strategjik ishte mbështetja e kërkimit shkencor dhe inovacionit që ndër të tjera do të synonte edhe rritjen e fondeve të dedikuara për zhvillimin profesional të personelit akademik dhe zhvillimin e aktiviteteve të tjera në këtë kuadër. Gjatë takimit në institucion GVJ u interesua nëse këto objektiva janë arritur dhe në çfarë niveli, si dhe sugjeroi hartimin e një raporti për arritjen e këtyre objektivave strategjike si dhe rinovimin e këtij plani strategjik për periudhën 2020 - e në vazhdim.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Gjatë takimit me personelin akademik përgjegjës për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, GVJ u informua se UL ofron vazhdimisht angazhimin e tij për ti dhënë mundësi pedagogëve të kenë një kualifikim dhe zhvillim profesional të vazhdueshëm. Këtu mund të përmendim trajnimet: “Mësimdhënia me në qendër studentin”; “How to write and publish an academic paper”; “Udhëzues për metodat inovative të mësimdhënies”; etj.</p> <p>Gjithashtu GVJ u informua se UL mbështet pjesëmarrjen e personelit në projektet kërkimore dhe mobilitetet e mundësuar prej ERASMUS+, si një mënyrë efektive për njohjen dhe përmirësimin e aftësive kërkimore dhe metodave inovative të mësimdhënies.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 9 Plani Strategjik.pdf</i> <i>Modul trajnimi “Learning assessment and student motivation”.pdf</i> <i>Moduli i trajnimit - How to write and to publish an academic paper.pdf</i> <i>Moduli i trajnimit - Mësimdhënia me në qendër studentin.pdf</i> <i>Evidenca 29 Udhëzues Metodat Inovative të Mësimdhënies.pdf</i> <i>Evidenca 20 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it-Moodle tutorial.pdf</i> <i>Evidenca 14 Marreveshjet Erasmus tabela.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ konstaton në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar (Aneks Tabelat Përmbledhëse – Tabelat 6 dhe 7), se gjatë vitit 2021 – 2022 për realizimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike janë angazhuar 26 pedagogë si personel akademik efektiv (PAE) dhe 14 pedagogë me kontratë (PAK). Titujt dhe gradat e personelit akademik janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 3 pedagogë me titullin akademik Profesor; - 8 pedagog me titullin akademik Profesor i Asociuar; - 12 pedagogë me gradën Doktor; - 17 pedagogë me kualifikimin MSc. <p>Bazuar tek tabelat 6 dhe 7 të aneksit për 4 vitet e fundit, si dhe nga takimet në vizitën në institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Informatikës Ekonomike, i cili është edhe njësi bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, ka një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e</p>

	objektivave të këtij programi, duke përbushur edhe kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit. Përsa i përket përbërjes së Departamentit të Informatikës Ekonomike në vetvete (Aneks Tabelat Përmbledhëse – Tabelat 1 dhe 2) ai gjithashtu është në përputhje me kërkesat ligjore për numrin e personelit efektiv akademik si dhe kualifikimet që duhet të kenë (të dhëna më të detajuara për numrin dhe kualifikimet e personelit akademik për 4 vitet e fundit janë dhënë më herët në këtë raport Standardi II.2).			
	Evidenca: <i>Aneks Tabelat Përmbledhëse, Tabela 1, 2, 6, 7</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>GVJ vizitoi mjediset e Universitetit Luarasi dhe konstatoi se institucioni ofron një infrastrukturë moderne, komode dhe të përshtatshme për grupet mësimore të këtij programi studimi, në përputhje me natyrën specifike të programit dhe modulet e tij, si dhe në përputhje me kriteret teknike dhe standardet e përcaktuara në bazën ligjore. Bazuar tek dokumentacioni i shqyrtuar (Aneks Tabelat Përmbledhëse – Tabela 16; Evidenca 34 Infrastruktura) GVJ konstaton se Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit i cili ofron këtë program studimi ka në dispozicion ndër të tjera 1 sallë leksioni, 3 salla seminaresh, 1 sallë për praktika lëndore, 1 laborator për lëndët, dhe 3 laboratorë informatike.</p> <p>Duke u bazuar tek numri i programeve (2 Bachelor dhe 2 Master) që ky fakultet ofron si dhe numri gjithnjë në rritje i studentëve të regjistruar, GVJ sugjeron që institucioni të marrë në konsideratë mundësinë e rritjes së kapacitetit të sallave të leksioneve dhe seminareve, për të siguruar mjedise të mjaftueshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore teorike.</p> <p>Evidenca: <i>Aneks Tabelat Përmbledhëse, Tabela 16</i> <i>Evidenca 34 Infrastuktura.pdf</i></p>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	<p>Gjatë vizitës në institucion si dhe mbështetur tek dokumentat e dorëzuara në dosjen e vetëvlerësimit (Evidenca 34 Infrastruktura), GVJ konstaton se sallat e leksioneve dhe të seminareve janë të pajisura me një set kompjuterash, videoprojektorë, lidhje interneti wireless dhe tabela mësimore që garantojnë më së miri realizimin e procesit mësimor teorik e praktik. Studentët dhe stafi kanë akses të plotë në sisteme që mundësojnë përdorimin e teknologjisë bashkëkohore, dhe i shërbejnë realizimit të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 34 Infrastuktura.pdf</i></p>




<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar institucioni zotëron 4 laboratorë të pajisur me teknologji bashkëkohore të informacionit, e përshtatshme kjo për plotësimin e kërkesave të programeve që UL ofron. Konkretisht në dispozicion të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, i cili ofron programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, janë 3 laboratorë informatike të pajisur me programe profesionale në përputhje me natyrën dhe modulet e këtij programi studimi. Mund të përmendim programet Microsoft Office365 ProPlus, Notepad++, Eclipse IDE for Java & C++ Developers, Google Chrome, Adobe Acrobat Reader DC, USB Disk Security, Cisco Packet Tracer, Teamviewer, Google Earth, XAMPP Control Panel, Avast Antivirus.</p> <p>Gjithashtu, laboratorët dhe mjediset e tjera mësimore janë të pajisura edhe me rrjet Interneti wireless me shpejtësi 100MB/s, në ndihmë të këtij programi studimi i cili është shumë i lidhur me përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe internetit.</p> <p>Për sa u tha më sipër, GVJ konkludon se mjediset mësimore (klasat, laboratorët, etj) të UL janë të pajisura me teknologji bashkëkohore e cila është në mbështetje të realizimit të objektivave formues të këtij programi studimi.</p> <p>Evidenca: <i>Aneks Tabelat Përmbledhëse, Tabela 16</i> <i>Evidenca 34 Infrastuktura.pdf</i> <i>Evidenca 34.1 Infrastuktura IT.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Gjithashtu, laboratorët dhe mjediset e tjera mësimore janë të pajisura edhe me rrjet Interneti wireless me shpejtësi 100MB/s, në ndihmë të këtij programi studimi i cili është shumë i lidhur me përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe internetit.</p> <p>Për sa u tha më sipër, GVJ konkludon se mjediset mësimore (klasat, laboratorët, etj) të UL janë të pajisura me teknologji bashkëkohore e cila është në mbështetje të realizimit të objektivave formues të këtij programi studimi.</p> <p>Evidenca: <i>Aneks Tabelat Përmbledhëse, Tabela 16</i> <i>Evidenca 34 Infrastuktura.pdf</i> <i>Evidenca 34.1 Infrastuktura IT.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>GVJ u informua në takimet me Dekanin e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit dhe Përgjegjësën e Departamentit të Informatikës Ekonomike se Universiteti Luarasi ka një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me kompani dhe institucione të sektorit publik dhe privat, të cilat mundësojnë praktikën profesionale të studentëve në programet e ndryshme të studimit. Konkretisht në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, UL ka nënshkruar 31 marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe kompani të sektorit publik dhe privat (Aneks Tabelat Përmbledhëse – Tabela 5).</p> <p>Sipas planit mësimor të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike (Aneks Tabelat Përmbledhëse – Tabela 10), moduli Praktikë dhe Zhvillim Karriere ka 60 orë seminar në auditor dhe 90 orë punë të pavarur nga studenti. Në takimin me studentët GVJ u informua që ata i zhvillojnë këto orë në laborator, për zhvillimin e programeve kompjuterike që i përkasin fushës së tyre të studimit, ndërsa orët e caktuara për punë të pavarur zhvillohen pranë institucioneve me të cilat UL ka nënshkruar marrëveshjet për zhvillimin e praktikave profesionale.</p> <p>Nga sa u tha më sipër GVJ konstaton se institucioni i ofron studentëve të gjitha mundësitë për të realizuar praktika profesionale në përputhje me standardet.</p> <p>Evidenca: <i>Aneks Tabelat Përmbledhëse, Tabela 5</i> <i>Aneks Tabelat Përmbledhëse, Tabela 10</i> <i>Evidenca 17 Institucionet bashkëpunuese me Luarasin.pdf</i> <i>Evidenca 18 Institucionet ku janë kryer praktikat mesimore.pdf</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>



Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB, Universiteti Luarasi ka një bibliotekë të cilën GVJ e vizitoi gjatë ditës së dytë të vizitës në institucion. Biblioteka është e vendosur në katin e tretë të godinës kryesore, në të cilën kanë akses të gjithë studentët që ndjekin studimet në këtë institucion. Biblioteka ka një sipërfaqe prej 43 m² dhe në sallën e studimit ka 20 poste leximi. Të gjithë studentët kanë mundësi të barabarta në përdorimin e saj, paradite ose mbasdite, dhe materialet e bibliotekës mund të përdoren ose në mjedisin e bibliotekës, ose mund të huazohen për përdorim të jashtëm në bazë të kërkesave të studentëve.</p> <p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar (Aneks Tabelat Përmbledhëse – Tabela 16), rezulton se Universiteti Luarasi ka dy salla biblioteke me një sipërfaqe 160 m², gjithashtu edhe në dokumentin (Evidenca 34 <i>Infrastuktura.pdf</i>) thuhet se institucioni ka dy biblioteka me një kapacitet 72 studentësh, një kompjuter për përdorim administrativ, një printer, 11 kompjutera për përdorim nga studentët, tavolina studimi, si dhe një tavolinë ovale për lexim.</p> <p>Shohim që ka një mospërputhje në përshkrimin për mjediset e bibliotekës që ky institucion disponon në dokumentat e sipërcituara. RVJ sugjeron të bëhet një unifikim i informacionit të deklaruar në këto dokumenta, në mënyrë që të evidentohen më mirë asetet e këtij institucioni në lidhje me bibliotekën.</p> <p>Evidenca: <i>RVB – Standardi IV.4, Kriteri 1 faqe 40</i> <i>Aneks Tabelat Përmbledhëse, Tabela 16</i> <i>Evidenca 34 Infrastuktura.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekën e Universitetit Luarasi, GVJ u njoh me fondin e literaturës fizike të kësaj biblioteke, që ishte në funksion të të gjitha programeve të studimit që ofrohen atje.</p> <p>GVJ konstaton se biblioteka disponon një numër të bollshëm titujsh të librave të detyruar dhe të rekomanduar për programet e ndryshme të studimit, gjithashtu disponohet një numër i konsiderueshëm leksionesh të përgatitura nga pedagogët, revistash shkencore dhe materialeve të tjera në ndihmë të studentëve. Megjithatë GVJ mendon se pavarësisht se institucioni i ka kushtuar rëndësi pasurimit të fondit të librave fizikë në bibliotekë, përsëri ka vend për shtimin e titujve të librave të literaturës bazë të detyruar sidomos në gjuhën shqipe, për të mbështetur nevojat e programit Bachelor në Informatikë Ekonomike (Evidenca 21 <i>Lista e literaturës në funksion të programit të studimit;.pdf</i>). Gjithashtu GVJ sugjeron se është e nevojshme që të përditësohet literatura me botime të pesë viteve të fundit.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 21 Lista e literatures ne funksion te programit te studimit;.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar (Evidenca 20 <i>Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it-Manual Perdoruesi Biblioteka Online.pdf</i>) si</p>

<p>në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>dhe vëzhgimeve në mjediset e bibliotekës, GVJ konstaton që institucioni ka ndërtuar një sistem elektronik të menaxhimit të fondit fizik të bibliotekës së tij. Me anë të këtij sistemi synohet të menaxhohet dhe përdoret me efikasitet fondi i bibliotekës, si nga ana e punonjësve të saj edhe nga studentët dhe pedagogët që mund të kërkojnë libra për huamarje apo lexim në sallë.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Përsa i përket aksesit në bibliotekat online të mirënjohura ndërkombëtare, GVJ konstaton që institucioni aktualisht nuk ka ndonjë abonim apo kontratë me to (Aneks Tabelat Përmbledhëse, Tabela 17). Gjithashtu në RVB referohet edhe linku https://ulibrary.rash.al/ por në dokumentat e paraqitura nuk ka ndonjë kontratë për përdorimin e portalit U-Library. Megjithatë në faqen e webit të universitetit (https://luarasi-univ.edu.al/bibloteka/) institucioni ofron një sërë link-esh që mundësojnë aksesin në biblioteka online. Biblioteka përdor burime elektronike të adresave që ofrojnë materiale falas (tekste, revista të huaja apo artikuj), që punonjësi i bibliotekës i evidenton përmes internetit.</p> <p>https://www.questia.com/?gclid=CIO63b_fx8oCFRATGwodzlgJzw</p> <p>Gjithashtu në faqen e webit të institucionit thuhet se Biblioteka e Universitetit Luarasi është e abonuar në platformën elektronike në “The Economist Magazine”.</p> <p>(https://www.economist.com/user/login?destination=node%2F21555491)</p> <p>Përdorimi i kësaj platformë elektronike është në ambjentet e bibliotekës në dobi të stafit akademik dhe studentëve.</p> <p>Burimet elektronike të adresave që ofrojnë materiale falas (tekste të plota dhe revista të huaja), punonjësi i bibliotekës i evidenton përmes internetit. Disa nga këto adresa të cilat janë funksionale për bibliotekën elektronike janë:</p> <p>http://www.thefreelibrary.com/ http://onlinebooks.library.upenn.edu/ http://archive.org/index.php http://books.google.com/ http://www.econlib.org/index.html http://www.theeuropeanlibrary.org/tel4/ https://www.bookshare.org/ http://www.jstor.org/ http://library.harvard.edu/</p> <p>Sikurse e përmendëm edhe më sipër, biblioteka përdor një sistem elektronik të informacionit, për të menaxhuar me efektivitet shërbimet e saj ndaj studentëve dhe pedagogëve. I gjithë fondi i bibliotekës është i informatizuar dhe i përpunuar sipas standardeve bibliografike ndërkombëtare.</p> <p>GVJ konkludon që institucioni ka krijuar kushte të barabarta të gjithë studentëve për aksesimin në bibliotekat online në PC e sallës, por sugjeron që në mjediset e bibliotekës së universitetit të shtohet numri i kompjuterave për ti shërbyer sa më mirë navigimit të studentëve në burimet online të literaturës.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 20 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it-Manual Perdoruesi Biblioteka Online.pdf</i> https://luarasi-univ.edu.al/bibloteka/ <i>Aneks Tabelat Përmbledhëse, Tabela 17</i> <i>RVB – Standardi IV.4, Kriteri 3 faqe 41</i> <i>Evidenca 34 Infrasuktura.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të</p>	<p>Sipas RVB dhe informacionit për bibliotekën që ndodhet në faqen e web-it të Universitetit Luarasi, fondi i bibliotekës është krijuar mbi bazën e</p>




bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	<p>blerjeve të vazhdueshme, nga stafi akademik, dashamirës të bibliotekës dhe nga donacione të ndryshme. Në takimin me personelin e bibliotekës GVJ u informua që institucioni është kujdesur që të pasurojë sa më shumë fondin e librave. Megjithatë në dokumentat e dorëzuara në dosjen e vetëvlerësimit GVJ nuk konstaton ndonjë dokument që të paraqesë planin e detajuar të shtimit të zërave të bibliotekës, në bazë të kërkesave të njëjësive bazë apo kryesore. GVJ sugjeron hartimin e një plani të detajuar vjetor për shtimin e literaturës që lidhet me këtë program studimi, apo përditësimin e literaturës ekzistuese me botime të 5 viteve të fundit.</p> <p>Evidenca: https://luarasi-univ.edu.al/bibloteka/</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Bazuar tek informacioni i marrë gjatë vizitës në bibliotekën e UL, GVJ konstaton që ajo qëndron e hapur në dispozicion të studentëve nga e hëna në të premte ora 08:30 – 20:00. Gjithashtu gjatë sezonit të provimeve biblioteka punon me orar të zgjatur. GVJ gjykon që orari është i përshtatshëm për tu shfrytëzuar nga studentët e interesuar duke qenë në një fashë të gjërë orari, pa ju cënuar oraret e zhvillimit të procesit mësimor. Informacioni për oraret është i afishuar në mjediset e bibliotekës si dhe në faqen e web-it të institucionit.</p> <p>Evidenca: https://luarasi-univ.edu.al/bibloteka/</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre që nga regjistrimi deri në diplomim administrohet në Sekretarinë Mësimore të universitetit, detyrat dhe përgjegjësitë e së cilës janë përcaktuar në Nenin 4 të Rregullores së Sekretarisë Mësimore. Sekretaria hap dhe ruan një dosje personale për çdo student që në regjistrimin e tyre duke kontribuar edhe në plotësimin e kontratave, plotëson të dhënat e studentëve në Regjistrin Themeltar, regjistron notat e studentëve në Regjistrin e Arritjeve Akademike si dhe përgjigjet për organizimin dhe mirëfunksionimin e procesit të lëshimit të diplomave si dhe mbajtjen e Regjistrit të të Dhënave të Studentëve të Diplomuar. Përveç administrimit të informacioneve në regjistrat fizikë dhe format elektronik, Sekretaria Mësimore përdor sistemin e menaxhimit të informacionit Luarasi Moodle-LMS. Gjithashtu GVJ u informua në takimin me përfaqësues të Sekretarisë Mësimore që institucioni ka lidhur marrëveshje me RASH dhe është duke implemetuar sistemin e sekretarisë mësimore Pitagora.</p> <p>GVJ u njoh me regjistrat gjatë vizitës në institucion dhe dosjet personale të studentëve. GVJ zgjodhi në mënyrë të rastësishme disa emra të studentëve të këtij programi studimi dhe konstatoi që të gjithë të dhënat e tyre në dosje, notat në regjistër dhe procesverbale, numrat e matrikullimit, etj, ishin pasqyruar korrekt. GVJ indentifikoi një rast të</p>



	<p>një studenti pa numër matrikullimi, dhe u informua që studentit ishte i transferuar nga jashtë (Bullgaria) dhe ishte në proces të njehsimit të diplomës së shkollës së mesme nga MAS.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 42 Regullore sekretari mesimore.pdf</i> https://luarasi-univ.edu.al/sekretaria-mesimore/ <i>Evidenca 20 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it-Moodle tutorial.pdf</i> <i>Minutat, Bsc Informatike Ekonomike.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>GVJ u informua gjatë vizitës në institucion si dhe nga dokumentat e shqyrtuara, se Universiteti Luarasi ka ndërtuar rrjetin e vet të brendshëm “Sharepoint” si pjesë e platformës Microsoft për të menaxhuar informacionin dhe dokumentacionin që lidhet me personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Gjithashtu aktiviteti akademik i stafit administrohet nëpërmjet Sistemit të Ngarkesës së Pedagogut, i cili lidh drejtuesit në nivel njësie kryesore dhe njësie bazë me stafin akademik, duke menaxhuar shpërndarjen e ngarkesës mësimore, lëndëve, klasave, etj. Ky sistem mundëson akses të dedikuar sipas lidhjes së stafit me departamentin ose fakultetin përkatës dhe anasjellta. Në dosjet elektronike që disponohen në rrjetin e brendshëm intranet personeli ka akses vetëm në dokumentacionin e vet, duke pasur mundësi leximi, modifikimi, shtimi, fshirje, etj, sipas privilegjeve të përcaktuara që në regjistrim.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga ana tjetër sistemi Luarasi Moodle – LMS, nëpërmjet moduleve të integruara bën lidhjen midis studentëve dhe pedagogëve duke ju mundësuar atyre aksesin e dedikuar në materialet mësimore sipas lëndëve apo klasave që ata janë duke ndjekur.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Evidenca: <i>Evidenca 20 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it -Manual Ngarkesa e Pedagogut.pdf</i> <i>Evidenca 20 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it-Moodle tutorial.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sikurse e përmendëm edhe më sipër aktiviteti akademik i stafit administrohet nëpërmjet Sistemit të Ngarkesës së Pedagogut, i cili lidh drejtuesit në nivel njësie kryesore dhe njësie bazë me stafin akademik, duke menaxhuar shpërndarjen e ngarkesës mësimore, lëndëve, klasave, etj. Ky sistem ju vjen në ndihmë drejtuesve të institucionit të kontrollojnë në kohë reale ngarkesën e pedagogëve për çdo lëndë. Gjithashtu nëpërmjet sistemit Luarasi Moodle – LMS monitorohet mbarëvajtja e procesit akademik, sepse sistemi nëpërmjet moduleve të tij gjeneron të dhëna statistikore që lidhen me zhvillimin e procesit mësimor në tërësi.</p> <p>Një tjetër sistem që ofron informacione është ai i vlerësimit online të pedagogut i cili zhvillohet në fund të semestrit, nëpërmjet të cilit drejtuesit e institucionit informohen për pjesëmarrjen e studentëve nëpër sondazhe si dhe rezultatet e përpunuara të pyetësorëve.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 20 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it -Manual Ngarkesa e Pedagogut.pdf</i></p>

	<p><i>Evidenca 20 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it-Moodle tutorial.pdf</i> <i>Evidenca 20 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së teknologjisë së it-Manual Vlerësimi i pedagogut Online.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ konstaton se Universiteti Luarasi disponon web site-n e vet (https://luarasi-univ.edu.al/en/) në të cilin janë të publikuara të gjitha informacionet në lidhje me programet e studimit që ai ofron, personelin akademik të përfshirë në to, aktivitetet e ndryshme të njësive kryesore, njësive bazë, si dhe informacione të tjera që lidhen me shërbimet, jetën studentore, projektet, etj. Informacionet janë të publikura në dy gjuhë: në shqip dhe në anglisht.</p> <p>Evidenca: https://luarasi-univ.edu.al/ https://luarasi-univ.edu.al/en/</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi IV.6 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Në bazë të Rregullores së Universitetit Luarasi, institucioni harton buxhetin vjetor dhe afatmesëm në tetor të çdo viti. Administratori harton projekt-buxhetin vjetor, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij. Buxheti miratohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Zbatimi i tij bëhet nga Administratori dhe Zyra e Financës.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar (Evidenca 26 Pasqyrat Financiare 2020.pdf; Aneks Tabelat Përmbledhëse Tabela 17) GVJ konstaton se institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimit që ai ofron në nivel institucional, jo të ndarë sipas programeve specifike, kjo për vetë natyrën e institucioneve jo publike të arsimit të lartë. Në bazë të këtyre dokumentave vihet re se kryesisht kostot e programeve të studimit mbulohen nga të ardhurat e siguruar nga tarifat e studimit të studentëve. Plani i financimit të programeve të studimit përmban të gjitha zërat që përcakton standardi. Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar (Evidenca 27 Raporti Audituesit 2020.pdf) GVJ konstaton se institucioni kryen auditimin e përvitshëm me auditues ligjor të pavarur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Universiteti Luarasi është pjesë e Hysenbelliu Group, dhe auditimi kryhet çdo vit për të gjitha pasqyrat financiare të Grupit. Këto pasqyra paraqesin në mënyrë të drejtë të gjitha aspektet materiale dhe pozicionin financiar të shoqërisë deri në fund të periudhës kontabile.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për</p>	<p>Evidenca: <i>Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Luarasi.pdf</i> <i>Evidenca 26 Pasqyrat Financiare 2020.pdf</i> <i>Aneks Tabelat Përmbledhëse, Tabela 18</i></p>


studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	<i>Evidenca 27 Raporti Audituesit 2020.pdf</i>			
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Gjatë vizitës në institucion, në takimin me Dekanin e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, GVJ u informua se Universiteti Luarasi si pjesë e Hysenbelliu Group dokumenton raporte të përvitshme financiare në nivel institucional, dhe jo të detajuara për programet specifike të studimit që ofron. Në bazë rezultateve të raportit të një viti, parashikohen ndërhyrje në buxhetin që miratohet nga bordi i administrimit për vitin pasardhës, duke plotësuar nevojat apo kërkesat që vijnë nga njësitë bazë apo njësitë kryesore.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Bazuar tek pasqyrat e raportit financiar (Evidenca 26 Pasqyrat Financiare 2020.pdf) si dhe raporti i auditit (Evidenca 27 Raporti Audituesit 2020.pdf), GVJ konstaton se UL dëshmon se garanton qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimit që ky institucion ofron. Bazuar tek tabelat e buxhetit (Aneks Tabelat Përmbledhëse, Tabela 18) konstatohet se të ardhurat janë në rritje, gjë që mbështet qëndrueshmërinë financiare të institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE


Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Universiteti Luarasi i ka përcaktuar të gjitha procedurat dhe politikat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve, nga hyrja e tyre deri në dalje, në Rregulloren e Universitetit Kreu VI, VIII, IX, XI; Rregulloren e Fakultetit Kreu V dhe VI; Rregulloren e Programit Kreu II dhe III. Këto politika dhe procedura janë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi përkatësisht me Ligjin Nr. 80/2015, dhe udhëzimin e MASR, Nr. 10, datë 15.05.2019 si edhe Udhëzimin e MASR, Nr. 17, datë 30.07.2019 për pranimin e studentëve në programin e ciklit të parë të studimeve Bachelor.

	<p>GVJ u informua gjatë vizitës në institucion në të gjitha takimet me njësitë e përfshira në zbatimin e këtyre procedurave që ato ndiqen me përpikmëri sipas përcaktimeve në rregulloret e sipërcituara. Kjo gjë u pohua edhe nga studentët e këtij program studimi.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Luarasi.pdf</i> <i>Evidenca 7 Rregullore Fakulteti.pdf</i> <i>Evidenca 8 Rregullore Programi.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Universiteti Luarasi garanton barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë apo studentët që ndjekin studimet në programet që ai ofron, nëpërmjet Statutit të UL Neni 53 dhe Kreu VII si dhe Rregullores së UL Neni 40 dhe Kreu VII.</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Përveçse në dokumentat kryesore të institucionit, kriteret e pranimit dhe informacionet e tjera për procedurat e regjistrimit që duhet të ndjekin kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në këtë program studimi janë të publikuara edhe në faqen e web-it të universitetit.</p> <p>Gjithshtu GVJ konstaton që kriteret dhe procedurat e sipërpërmendura janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme për cilindo që është i interesuar nëpërmjet faqes së web-it të institucionit, Rregulloreve të institucionit si dhe kanaleve të tjera formale të informimit.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Luarasi.pdf</i> <i>Evidenca 7 Rregullore Fakulteti.pdf</i> https://luarasi-univ.edu.al/kriteret-e-pranimit-2017-2018/#</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton që institucioni harton dhe publikon edhe kriteret të veçanta për pranimin e kandidatëve në programet e studimit që ai ofron. Specifikisht për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike janë përcaktuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta si më poshtë:</p>
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Pranohen kandidatët që:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vërtetojnë me dokument zyrtar përfundimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë vendit (të ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit). 2. Plotësojnë kriterin e notës mesatare minimale sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave. 3. Renditja e aplikantëve do të kryhet duke u bazuar në kriteret e më poshtme: <ol style="list-style-type: none"> a) 70% e notës mesatare aritmetike të shkollës së mesme, përfshirë provimet e maturës shtetërore; b) dhe me 30% mesataren për lëndët e provimeve me zgjedhje të maturës shtetërore. <ul style="list-style-type: none"> • Lëndët me zgjedhje të maturës shtetërore janë si vijon: Ekonomi 15%, Gjuhë e Huaj 15%. 4. Plotësojnë kriteret e tjera të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. <p>Gjithashtu institucioni ka parashikuar edhe kriteret për regjistrimin e studentëve të huaj. Sipas Rregullores së Programit Bachelor në Informatikë Ekonomike për shtetasit e huaj që duan të regjistrohen në këtë program studimi, përveç kushteve të mësipërme, duhet të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Paraqesin kopjen e noterizuar të lejes së qëndrimit në momentin e regjistrimit. 2. Paraqesin dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, të lëshuar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë në UT.




	<p>3. Plotësojnë kriteret e tjera të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 8 Rregullore Programi Neni 6.pdf</i> https://luarasi-univ.edu.al/kriteret-e-pranimit-2017-2018/#</p>			
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>GVJ u informua në takimin me Dekanin e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit se në periudhën përpara provimeve të maturës, ata organizojnë takime informuese me gjimnazistët për ti informuar në lidhje me programet e studimit që ofrohen nga Universiteti Luarasi si dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta që duhet të përmbushin kandidatët për tu pranuar në to.</p> <p>Gjithashtu universiteti informon publikun dhe të interesuarit për kriteret e pranimit, nëpërmjet faqes zyrtare të web-it, kanaleve televizive si New 24, rrjeteve sociale, si dhe Guidës Luarasi. Në fillim të çdo viti akademik, gjithashtu institucioni zhvillon takime informuese në mjediset e tij, me këdo kandidat për student që është i interesuar.</p> <p>Evidenca: https://luarasi-univ.edu.al/kriteret-e-pranimit-2017-2018/# Guida Luarasi.pdf</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Të gjitha procedurat dhe kriteret që lidhen me përparimin akademik dhe kalimin nga një vit në tjetrin të studentëve në Universitetin Luarasi janë përcaktuar në mënyrë të hollësishme në Rregulloren e Universitetit Kreu VIII “Rregullat e Studimeve”. Gjithashtu këto procedura janë të shprehura edhe në Rregulloren e Programit të Studimit Neni 15. Studentët njihen me të gjitha këto kriteret dhe procedura nëpërmjet këtyre dokumentave të cilat janë të disponueshme për secilin prej tyre. Gjithashtu GVJ konstaton që studentët informohen në mënyrë të hollësishme nga pedagogët për këto procedura në fillim të studimeve të tyre që në vitin e parë, si dhe në fillim të çdo semestri secili pedagog prezanton syllabusin e lëndës si dhe procedurat për përparimin akademik, detyrimet e lëndës, mënyrën e vlerësimit, kërkesat për frekuentimin, etj.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Luarasi.pdf</i> <i>Evidenca 8 Rregullore Programi.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat për njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose të studimeve të pjesëshme janë të përcaktuara në Rregulloren e UL Neni 52 dhe 53; Rregulloren e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit Neni 25, 27; Rregulloren e Programit të Studimit Bsc në IE Neni 8. GVJ konstaton se këto kriteret ju vihen në dispozicion të gjithë studentëve të interesuar që duan të transferojnë studimet në këtë</p>



	<p>institucion si dhe ata që duan të largohen prej tij, apo duan të bëjnë njohjeve të kualifikimeve të mëparëshme apo studimeve të pjesëshme. Sipas Rregullores së UL kërkesa për tansferim e një studenti midis programeve të të njëjtit cikël studimi brenda institucionit apo nga një institucion tjetër i arsimit të lartë në Universitetin “Luarasi”, së bashku me dosjen përkatëse, shqyrtohet nga Komisioni i ekuivalentimit të krediteve të fakultetit përkatës, ku kërkon të transferohet studenti. Komisioni i ekuivalentimit të krediteve ngrihet pranë çdo fakulteti me urdhër të drejtuesit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe përbëhet nga jo më pak se tre anëtar, të stafit akademik me kohë të plotë të kësaj njësie. Sekretaria mësimore i përcjell komisionit dosjen e studentit që kërkon të transferojë studimet. Brenda një jave nga marrja në dorëzim e dosjes komisioni i ekuivalentimit të krediteve shprehet me vendim për vitin akademik në të cilin studenti transferohet si dhe për njohjen e plotë ose të pjesëshme të krediteve të fituara nga studenti.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Luarasi.pdf</i> <i>Evidenca 7 Rregullore Fakulteti.pdf</i> <i>Evidenca 8 Rregullore Programi.pdf</i> <i>Syllabus IE Viti III 21-22.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton që studentët e këtij programi studimi informohen në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve në fillim të çdo semestri kur bëhet prezantimi i çdo lënde. Këto kritere janë të shprehura qartë në çdo syllabus të lëndëve. Gjithashtu institucioni i ka të përcaktuara këto procedura në detaje edhe në Rregulloren e UL Neni 71; Rregulloren e Programit Neni 15 të cilat janë në dispozicion të çdo studentit.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Luarasi.pdf</i> <i>Evidenca 8 Rregullore Programi.pdf</i> <i>Syllabus IE Viti III 21-22.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në UL përcaktohen në mënyrë të detajuar në Rregulloren e UL Kreu XI. Në të është përcaktuar që diploma në ciklin e parë të studimeve mbrohet me provim ose me temë diplome. Kriteri për përcaktimin e mbrojtjes me temë apo provim të diplomës së studimeve të ciklit të parë Bachelor është mesatarja e notave të fituara nga studenti deri në semestrin e pestë përpara diplomimit.</p> <p>Në lidhje me programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, këto procedura dhe kritere janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e Programit Kreu III. Studentët e përfundojnë programin e studimit me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome nëse e kanë mesataren mbi 8.</p> <p>Studentët informohen për këtë nëpërmjet pedagogëve dhe Sekretarisë Mësimore. Ata duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet e lëndëve, si dhe detyrime të tjera që lidhen me institucionin përpara se të japin diplomën. Gjithashtu studentëve ju vihet në dispozicion edhe udhëzuesi për shkrimin e diplomës si dhe informohen për çdo gjë nga udhëheqësit e tyre.</p> <p>Në takimin me studentët gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se të gjithë studentët kishin marrë informacionet e nevojshme për të gjithë procesin e diplomimit të tyre, qoftë ata me provim formimi (Rregullore e Programit Kreu III Neni 17). qoftë ata me temë (Rregullore e Programit Kreu III Neni 18, 19).</p>




	<p>Evidenca: Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Luarasi.pdf Evidenca 8 Rregullore Programi.pdf Evidenca 22.1 Udhezuesi i shkrimit te diplomes.pdf</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Sikurse e kemi përmendur edhe në Standardin V.1, përfaqësues të institucionit organizojnë takime informuese me gjimnazistët në të gjithë vendin, në periudhën përpara provimeve të maturës, për ti informuar ata në lidhje me programet e studimit që ofrohen nga Universiteti Luarasi si dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta që duhet të përmbushin kandidatët për tu pranuar në to.</p> <p>Gjithashtu universiteti informon publikun dhe të interesuarit për programet e studimit, nëpërmjet faqes zyrtare të web-it, kanaleve televizive si New 24, rrjeteve sociale, si dhe Guidës Luarasi. Në fillim të çdo viti akademik, gjithashtu institucioni zhvillon takime informuese në mjediset e tij, me këdo kandidat për student që është i interesuar.</p> <p>Evidenca: https://luarasi-univ.edu.al/fakulteti-i-teknologjise-se-informacionit-dhe-inovacionit/ https://luarasi-univ.edu.al/kriteret-e-pranimit-2017-2018/# Guida Luarasi.pdf</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se studentët në Universitetin Luarasi informohen që në vitin e parë në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programeve të studimit ku ata janë të regjistruar. Ashtu sikurse është evidentuar edhe në standardin V.2 të kësaj fushe, institucioni zhvillon javën e orjentimit të studentëve të rinj, ku kryhen takime informuese me dekantët e fakulteteve, koordinatoret e programeve, përgjegjësit e departamenteve si dhe pedagogët që japin mësim në programet përkatëse.</p> <p>Për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, Përgjegjësi i Departamentit të Informatikës Ekonomike i njeh studentët me Rregulloren e Programit në përgjithësi, dhe me Nenin 5 i cili përcakton edhe mënyrën e organizimit të këtij programi.</p> <p>Një informacion të hollësishëm studentët e marrin nga Guida Luarasi e cila përmban informacion të detajuar për programet përfshirë edhe planin mësimor (plani mësimor i detatjuar dhe plani mësimor sipas veprimtarive formuese). Studentët orjentoohen të navigojnë edhe informacionet që gjenden në faqen e web-it të institucionit në lidhje me programin e studimit të tyre, për tu njohur me strukturën dhe organizimin e tij.</p> <p>Pedagogët në fillim të çdo lënde ju prezantojnë studentëve syllabueset të cilat përmbajnë informacion të detajuar për lëndën, detyrimet, literaturën, kreditet, etj.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	

	<p>Evidenca: <i>Evidenca 8 Rregullore Programi.pdf</i> <i>Guida Luarasi.pdf</i> <i>Sylabus IE Viti III 21-22.pdf</i> https://luarasi-univ.edu.al/fakulteti-i-teknologjise-se-informacionit-dhe-inovacionit/</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>GVJ u informua gjatë vizitës në institucion, si dhe konfirmon nëpërmjet dokumentave të shqyrtuara se, për informimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit si dhe orjentimin e tyre në tregun e punës kujdeset Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës të Universitetit Luarasi. Kjo zyrë është gjithë kohën në dispozicion të studentëve për këshillimin e karrierës, ju jep studentëve informacione rreth mundësive të ndryshme që institucioni në bashkëpunim me partnerët ofron për trajnimet, aktivitete të ndryshme, internshipe, praktika profesionale dhe mundësitë e punësimit.</p> <p>Një tjetër mundësi konkrete për studentët për tu informuar rreth tregut dhe mundësive të punësimit është edhe panairi i punës që organizohet në mënyrë periodike apo edhe takimet e hapura me eksperët të fushës së TI.</p> <p>Përsa i përket programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në bazë të dokumentit “Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve për periudhën 2018 - 2021, Tabela 23” konstatohet se numri i të diplomuarve është 47 ku 25 prej të cilëve janë punësuar në pozicione që përputhen me profilin e diplomës (53%).</p> <p>Evidenca: <i>Aneks Tabela Permbledhese Informatike Ekonomike-Tabela 23.pdf</i> <i>Evidenca 10 Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit.pdf</i> <i>Evidenca 24 Rregullore Zyra e Studentit dhe Keshillimit te Karrieres.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Sikurse është cilësuar edhe në kriteret e mësipërme të këtij standardi, çdo vit akademik Departamenti i Informatikës Ekonomike përgjegjës për programin e studimit së bashku me Dekanatin e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit organizojnë takime informuese të përshtatjes së studentëve që regjistrohen në vit të parë për Universitetin, Fakultetin dhe programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike. Studentëve ju jepet një informacion i gjerë dhe i detajuar për të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me procesin mësimor, kohëzgjatjen e studimeve, lëndët, përmbajtjen e tyre, mënyrat e vlerësimit, planin mësimor, etj. Gjatë këtyre takimeve shpjegohen në detaje edhe struktura e Universitetit Luarasi, objektivat strategjike, struktura e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, prezantohen drejtuesit, bëhet prezantimi i infrastrukturës, bibliotekës, laboratorëve, klasave të leksioneve dhe seminareve, etj.</p>
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>GVJ u informua se një peshë të rëndësishme në lidhje me informimin e studentëve ka sekretarja mësimore e programeve Bachelor, e cila njofton studentët për kalendarin akademik, çdo ndryshim orari, ose ndryshime në zbatimin e programit, të reja apo edhe paqartësi që duhen njoftuar dhe sqaruar, etj.</p> <p>Për të gjitha sa më sipër studentët informohen përmes postës elektronike dhe sistemit Luarasi Moodle-LMS si dhe Ms Teams.</p> <p>GVJ konstaton se që në vitin akademik 2018-2019 stafi zhvillues i TI së Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit ka</p>




	<p>dizenjuar platformën Luarasi Moodle-LMS si dhe ka përshtatur për nevojat e veta dhe Microsoft Teams. Në këtë mënyrë çdo informacion në lidhje me programin e studimit në të gjitha njësitë e Universitetit shkëmbehet përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe është i aksesueshëm nga të gjithë studentët.</p> <p>Evidenca: Evidenca 20 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it-Moodle tutorial.pdf</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni mban statistika vjetore për numrin e të diplomuarve për çdo program studimi. Ashtu sikurse është theksuar edhe në Standardin IV.5, Sekretaria Mësimore përgjigjet për organizimin dhe mirëfunksionimin e procesit të lëshimit të diplomave si dhe mbajtjen e Regjistrit të të Dhënave të Studentëve të Diplomuar. GVJ u njoh me Regjistrin e Diplomave gjatë vizitës në institucion dhe konstatoi që të dhënat ruheshin sipas standardit.</p> <p>Përsa i përket programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, të dhëna statistikore për numrin e të diplomuarve për periudhën 2018 – 2021 janë të paraqitura edhe në Aneks Tabelat Përmbledhëse – Tabela 23.</p> <p>Përveç Regjistrit të Diplomave, Sekretaria hap dhe ruan një dosje personale për çdo student që në regjistrimin e tyre, plotëson të dhënat e studentëve në Regjistrin Themeltar si dhe regjistron notat e studentëve në Regjistrin e Arritjeve Akademike.</p> <p>Gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore, GVJ u njoh me statistikat që kjo zyrë mbante për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, që përmbanin: të dhëna në lidhje me mesataret në hyrje dhe në dalje, rekordet për të larguarit, transferimet, etj. Këto të dhëna janë të evidentura edhe në Aneks Tabelat Përmbledhëse -Tabela 21 si dhe në dokumentin “Të dhëna të plota për regjistrimin e studentëve”. Gjithashtu në Sekretarinë Mësimore mbahet dokumentacioni që tregon rezultatet e ndërmjetme dhe përfundimtare të studentëve gjatë gjithë ecursisë së programit të studimit. Rezultatet regjistrohen në procesverbalet sipas lëndëve në përputhje me kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 Neni 101. Më pas notat hidhen në Regjistrin e Arritjeve Akademike.</p> <p>Evidenca: Aneks Tabela Permbledhese Informatike Ekonomike.pdf Evidenca 42 Regullore sekretari mesimore.pdf Evidenca 38 Të dhëna të plota për regjistrimin e studentëve.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit</p>	<p>Sikurse e kemi përmendur edhe në standardet e mësipërme GVJ u informua që Universiteti Luarasi ka nënshkruar kontratën me RASH për implementimin e sistemit të menaxhimit të informacionit Pitagora.</p>

<p>dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Aktualisht të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen në sekretarinë mësimore nëpërmjet regjistrave fizikë dhe në format elektronik. Gjithashtu Sekretaria Mësimore përdor sistemin e menaxhimit të informacimit Luarasi Moodle-LMS.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 42 Regullore sekretari mesimore.pdf</i> <i>Evidenca 20 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it-Moodle tutorial.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni harton raporte analitike për cilësinë e studentëve gjatë viteve akademike, si dhe për punësimin e tyre nëpërmjet Zyrës së Sekretarisë Mësimore si dhe në departament gjatë analizës vjetore të departamentit. Të dhënat i gjejmë edhe në Aneks Tabelat Përmbledhëse -Tabela 21, 23 si dhe në dokumentin “Të dhëna të plota për regjistrimin e studentëve”.</p> <p>Zyra e Këshillimit të Karrierës mban gjithashtu kontaktet me studentët e diplomuar nëpërmjet strukturës “Luarasi Alumni”.</p> <p>Gjithashtu institucioni ka realizuar edhe studimin e tregut, për të analizuar mundësitë e punësimit të studentëve të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike dhe ka hartuar një raport duke përcaktuar edhe kërkesat e tregut për ardhmen.</p> <p>Evidenca: <i>Aneks Tabela Përmbledhëse Informatike Ekonomike.pdf</i> <i>Evidenca 38 Të dhëna të plota për regjistrimin e studentëve.pdf</i> <i>Minutat, Bsc Informatike Ekonomike.pdf</i> <i>Evidenca 15 Analizë e Departamentit përgjegjës për programin e studimit.pdf</i> <i>Evidenca 10.1 Raport Studim Tregu Universiteti Luarasi.pdf</i> <i>Evidenca 12 Të dhëna tabelore për punësimin real të studentëve.pdf</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.5</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Neni 98, 99 Universiteti Luarasi garanton përfshirjen e studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese të tij. Në bazë të Statutit Neni 63 dhe Rregullores Neni 57 së Universitetit Luarasi, studentët përfaqësohen në këto struktura vendimmarrëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Këshillin studentor, i cili realizon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese. - Senatit Akademik ku ka përfaqësues të studentëve. - Këshillin e Etikës, ku ka një përfaqësues të studentëve. - NJBSC, ku ka një anëtar përfaqësues nga Këshilli Studentor. - Si dhe mbledhjet e departamenteve një herë në muaj janë të hapura për studentët.
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me</p>	




<p>rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Këshilli studentor është organi më i rëndësishëm i studentëve i cili përfaqëson dhe mbrohet interesat studentore. Ai zgjidhet çdo dy vjet në mënyrë demokratike nga vetë studentët. Këshilli organizohet në nivel institucional me përfaqësues nga të gjitha fakultetet.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion në takimin me studentët GVJ u informua se nevojat dhe shqetësimet e tyre janë adresuar vazhdimisht në organet drejtuese dhe vendimmarrëse të institucionit. Departamenti i Informatikës Ekonomike si dhe Dekanati i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit i mirëpresin sugjerimet dhe vërejtjet e studentëve për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe mardhënien me institucionin. Gjithashtu GVJ u informua që është e mirëpritur pjesëmarrja e përfaqësuesve të studentëve çdo muaj në mbledhjet e departamentit.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 6 Statuti Universiteti Luarasi.pdf</i> <i>Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Luarasi.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>GVJ konstaton se hartimi i Planit Mësimor të këtij programi është bërë në përputhje me VKM Nr. 879, datë 18.12.2019. Programi Bachelor në Informatikë Ekonomike është me një kohëzgjatje 3 vjet dhe në fund të diplomimit studentët pajisen me 180 kredite evropiane (ECTS). Çdo vit akademik zgjat 30 javë mësimore i ndarë në 2 semestra me nga 15 javë.</p> <p>Numri i krediteve sipas viteve është përkatësisht 60 kredite për vitin e parë, 60 kredite për vitin e dytë dhe 60 kredite për vitin e tretë. Kreditet minimale evropiane për një lëndë janë 4 ECTS dhe maksimumi 6 ECTS, ndërsa Tema e diplomës/Provimi përfundimtar 9 ECTS. Sipas Planit Mësimor ka një shpërndarje të ekuilibruar ndër vite midis numrit të orëve në auditor plus studimit individual. Kjo shpërndarje lehtëson edhe procedurat për transferimin e studentëve nga institucione të tjera ose drejt Universitetit Luarasi. Sikurse është evidentuar edhe në standardet e mësipërme, kriteret dhe procedurat për njohjen e kualifikimeve të mëparëshme ose të studimeve të pjesëshme janë të përcaktuara në Rregulloren e UL Neni 52 dhe 53; Rregulloren e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit Neni 25, 27; Rregulloren e Programit të Studimit Bsc në IE Neni 8. GVJ konstaton që këto procedura janë të thjeshta dhe lehtësisht të kuptueshme nga studentët.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Luarasi.pdf</i> <i>Evidenca 7 Rregullore Fakulteti.pdf</i> <i>Evidenca 8 Rregullore Programi.pdf</i> <i>Aneks Tabela Permbledhese Informatike Ekonomike.pdf</i> <i>Evidenca 11 Programi i studimit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Mbështetur tek Plani Mësimor i paraqitur në dosjen e vetëvlerësimit si dhe gjatë vizitës në institucion GVJ u informua që programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike është zbatuar i pandryshuar që në hartimin e tij në vitin akademik 2018 -2019. Megjithatë GVJ u informua që një rol të rëndësishëm në përmirësimin e programit të studimit në vazhdim do të kenë raportet e hartuara nga mbledhjet dhe analizat në departament si dhe nga rezultatet e pyetorëve të studentëve, të cilët sugjerojnë përmirësime konkrete apo evidentojnë problematika të ndryshme me programin dhe zbatimin e tij.</p>




	Evidenca: <i>Evidenca 11 Programi i studimit.pdf</i>			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Gjatë takimit me studentët GVJ u informua se atyre ju jepet mundësia të vlerësojnë performancën e pedagogëve në të gjitha aspektet e procesit mësimor, që nga procesi i mësimdhënies deri tek vlerësimi. Mënyra e kontrollit të dijeve bëhet e qartë për studentët nëpërmjet syllabusit, si dhe nga pedagogu i lëndës. Provimet korrigjohen të sekretuara. Studentët kanë të drejtë të ankimojnë vlerësimin e marrë duke bërë kërkesë për rivlerësim tek një komision i posaçëm, i përbërë nga dy pedagogë, të cilët reflektojnë rezultatin e ri në sekretari. Procedura e ankimimit është përcaktuar në Rregulloren e Universitetit Luarasi Neni 75.			
	Evidenca: <i>Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Luarasi.pdf</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6 Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	GVJ konstaton se institucioni ka ngritur procedura dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit të studentëve, të përcaktuara këto në Rregulloren e Universitetit Neni 103, sipas të cilit Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës është struktura përgjegjëse që organizon, menaxhon dhe drejton procesin e rekrutimit të studentëve të rinj, mban marrdhënie të vazhdueshme me këshillat studentorë, drejton procesin e këshillimit të studentëve, mban komunikimin me tregun e punës, si dhe i ofron asistencë në orientimin dhe këshillimin e karrierave profesionale studentëve. Funkcionet, detyrat, anëtarët, drejtuesit, etj, të kësaj zyre janë të përcaktuara më në detaje në Rregulloren e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës. Në bazë të dokumentit Plani Vjetor i Punës për Departamentin e Karrierës për vitin akademik 2018-2019, GVJ konstaton që kjo zyrë ka hartuar një plan veprimi për orientimin, informimin dhe mbështetjen e studentëve. Sugjerojmë që ky plan veprimi të vazhdohet apo përditësohet edhe për vitet në vazhdim. Një rol të rëndësishëm në mbështetjen dhe informimin e studentëve ka departamenti i Informatikës Ekonomike dhe seancat e tutoriatit dhe këshillimit akademik nga këshilluesit e karrierës dhe personeli akademik.
	Evidenca: <i>Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Luarasi.pdf</i> <i>Evidenca 24 Rregullore Zyra e Studentit dhe Keshillimit te Karrieres.pdf</i> <i>Evidenca 24.1 Zyra e karrieres.pdf</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e	Sikurse është cilësuar edhe në kriteret e mësipërme përveç Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, çdo vit akademik Departamenti i Informatikës Ekonomike përgjegjës për programin e studimit së




<p>përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>bashku me Dekanatin e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit organizojnë takime informuese me studentët që regjistrohen në vit të parë. Studentëve ju jepet një informacion i gjërë dhe i detajuar për të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me procesin mësimor, kohëzgjatjen e studimeve, lëndët, përmbajtjen e tyre, mënyrat e vlerësimit, planin mësimor, etj. GVJ u informua se një rol të rëndësishme në lidhje me informimin e studentëve ka sekretarja mësimore e programeve Bachelor.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 24 Rregullore Zyra e Studentit dhe Keshillimit te Karrieres.pdf</i> <i>Evidenca 42 Rregullore sekretari mesimore.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Sikurse e theksuam edhe në Kriterin 1 të këtij standardi, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës është struktura përgjegjëse që organizon, menaxhon dhe drejton procesin e rekrutimit të studentëve të rinj, mban marrdhënie të vazhdueshme me këshillat studentorë, drejton procesin e këshillimit të studentëve, mban komunikimin me tregun e punës, si dhe i ofron asistencë në orientimin dhe këshillimin e karrierae profesionale studentëve. GVJ në takimin që zhvilloi me përfaqësues të kësaj zyre, u informua në detaje për rolin e saj si dhe aktivitetet e që zhvillonte. Përveç shërbimit të kësaj zyre në lidhje me zgjedhjen e institucioneve për zhvillimin e praktikave profesionale, studentët asistohen edhe nga stafi akademik dhe koordinatori i programit të studimit.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Luarasi.pdf</i> <i>Evidenca 24 Rregullore Zyra e Studentit dhe Keshillimit te Karrieres.pdf</i> <i>Evidenca 24.1 Zyra e karrieres.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Në bazë të Rregullores së Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës Neni 8, kjo zyrë ka për detyrë edhe mbajtjen e kontakteve me alumnët, me synim mbledhjen e të dhënave për punësim të të diplomuarve si dhe ndërtimin e bazës së të dhënave dhe nxjerrjen e statistikave për nivelin e punësimit të studentëve. Një tregues i këtyre statistikave është edhe dokumenti “Të dhëna tabelore për punësimin real të studentëve” i cili ka të dhëna për punësimin e studentëve të programit Bachelor në Informatikë Ekonomike.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 24 Rregullore Zyra e Studentit dhe Keshillimit te Karrieres.pdf</i> <i>Evidenca 12 Te dhena tabelore per punesimin real te studenteve.pdf</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--




VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>GVJ konstaton se Universiteti Luarasi ka ngritur me Vendim të Senatit Akademik Nr. 12/4 datë 23.12.2016 Njësinë e Brendëshme të Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) e cila vepron si njësi e përherëshme përgjegjëse për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Kodin e Cilësisë miratuar me VKM Nr. 531, datë 11.09.2018, udhëzimet e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, si dhe aktet rregullatore institucionale.</p> <p>Kjo njësi funksionon në bazë të Statutit të Universitetit Luarasi Kreu VIII dhe Manualit të NJBSC. Kjo njësi është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Ajo përbëhet nga 5 anëtarë nga të cilët 3 janë përfaqësues të personelit akademik të njëjve kryesore, 1 përfaqësues i studentëve dhe 1 ekspert i jashtëm.</p> <p>GVJ konstaton që institucioni ka hartuar dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe ka një sistem funksional.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 32.2 Vendim mbi ngritjen e NJSBC.pdf</i> <i>Evidenca 32 Manuali NJSBC.pdf</i> <i>Evidenca 32.1 Strategjia e NJBSC.pdf</i> <i>Evidenca 6 Statuti Universiteti Luarasi.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në bazë të Statutit të Universitetit Luarasi Kreu VIII Neni 74, institucioni i nënshtrohet procesit të vlerësimit të jashtëm të cilësisë dhe akreditimit institucional dhe të programeve të studimeve, në përputhje me përcaktimet e LAL nr. 80/2015, datë 22.07.2015.</p> <p>Me vendim të Bordit të Akreditimit nr. 115, datë 15/12/2017 Universiteti Luarasi (ish Kolegji Universitar Luarasi) është akredituar në nivel institucional. Gjithashtu janë akredituar një sërë programesh studimi që ky institucion ofron.</p> <p>Përsa i përket programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, ky program po i nënshtrohet procesit të akreditimit për herë të parë, pasi është licensuar me Urdhër të MASR Nr. 417, datë 16 Korrik 2018. Sipas dokumentit të hapjes UMASR Nr. 417, datë 16.07.2018, programi ka filluar veprimtarinë akademike në vitin akademik 2018-2019.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 1 Urdher Hapje Programi.pdf</i> <i>Evidenca 2.1 Vendim Akreditimi Institucional.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Në bazë të dokumentave (Manuali i sigurimit të brendshëm të cilësisë, Neni 1) të shqyrtuara si dhe takimit me NJBSC, GVJ konstaton se kjo njësi monitoron dhe mbikqyr realizimin në praktikë të Plan-Veprimit të Vetëvlerësimit të cilësisë të paraqitur nga Rektori. Njësia koordinon</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p>	<p>Në bazë të dokumentave (Manuali i sigurimit të brendshëm të cilësisë, Neni 1) të shqyrtuara si dhe takimit me NJBSC, GVJ konstaton se kjo njësi monitoron dhe mbikqyr realizimin në praktikë të Plan-Veprimit të Vetëvlerësimit të cilësisë të paraqitur nga Rektori. Njësia koordinon</p>



<p>Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>të gjitha aktivitetet që kanë si qëllim sigurimin e cilësisë dhe promovon kulturën e cilësisë në njësitë përkatëse.</p> <p>Në bazë të “Manualit të sigurimit të brendshëm të cilësisë, Neni 3”, NJBSC planifikon dhe organizon Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë në dy aspekte:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlersësimin e brendshëm të cilësisë së programeve të studimit 2. Vlerësimin e brendshëm institucional <p>Procedurat që ndiqen për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit janë përcaktuar në “Manualin i sigurimit të brendshëm të cilësisë, Neni 9”.</p> <p>Në fund vitit akademik NJBSC përgatit një raport vjetor në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e brendshëm të cilësisë. Këto raporte shqyrtohen nga organet drejtuese të institucionit dhe reflektohen në vendimmarrje konkrete.</p> <p>Evidenca: Evidenca 32 Manuali NJSBC.pdf</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.2</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Sikurse e cilësuam edhe në standardin VI.1, Universiteti Luarasi ka ngritur Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë e cila vepron në nivel institucional. Në bazë “Manualit të sigurimit të brendshëm të cilësisë, Neni 3” një nga detyrat e kësaj njësie është edhe vlersësimi i brendshëm i cilësisë së programeve të studimit përfshirë këtu edhe ato të ciklit të parë bachelor.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Sikurse është cilësuar edhe në Stanard II.3 të këtij raporti, në dosjen e vetëvlerësimit nuk kemi ndonjë dokument i cili të pasqyrojë ndryshime të mëdha që mund ti jenë bërë planit mësimor të këtij programi studimi, e njëjta gjë duket edhe në Tabelën 11 të Aneksit të Tabelave Përmbledhëse. Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se nuk kishin ndodhur ndryshime që kanë rezultuar në prezantimin e lëndëve të reja, por më tepër ka pasur përmirësime në përmbajtjen e programeve lëndore të lëndëve të ofruara me kapituj të rinj. Synimi i njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit ka qenë konsolidimi fillestar i kurrikulës së programit e më pas përmirësimi gradual i tij.</p> <p>Evidenca: Evidenca 32.2 Vendim mbi ngritjen e NJSBC.pdf Evidenca 32 Manuali NJSBC.pdf Aneks Tabela Permbledhese Informatike Ekonomike.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Sikurse është cilësuar edhe në Standardin III të këtij raporti, si dhe mbështetur tek dokumentacioni i shtyrtuar, GVJ konstaton që mekanizmat kryesorë që përdor NJBSC për mbikëqyrjen e programeve të studimit dhe të procesit mësimor janë disa:</p>



<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Monitorimi i procesit mësimor pa paralajmërim, me fokus vëzhgimin e disa elementeve në mësimdhënie, si përdorimi i mjeteve didaktive në funksion të mësimdhënies, komunikimi me klasën, tërheqja e studentëve në ndërveprim, etj. • Vlerësimi i pedagogëve nga kolegët nëpërmjet plotësimit të formularit përkatës të vlerësimit ku kolegu vlerëson programin e lëndës, si edhe materiale të tjera didaktike që pedagogu përdor gjatë orës së mësimi. • Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga ana e studentëve nëpërmjet analizës së vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies në shkollat e larta mbi bazën e metodave statistikore. <p>Për secilën nga mekanizmat e mësipërme, NJBSC përdor një metodologji të caktuar për të nxjerrë raporte dhe konkluzione vlerësimi. Rezultatet e vlerësimit të procesit të mësimdhënies i bëhen me dije çdo pedagogu në mënyrë konfidenciale. Kjo praktikë u konfirmua edhe nga anëtarët e stafit akademik gjatë vizitës në institucion. Gjithashtu rezultatet e vlerësimit nëpërmjet pyetësorëve të studentëve përpunohen dhe përcillen pranë Rektorit të Institucionit i cili reflekton analizën e tyre në bashkëpunim me përgjegjësin e njësisë kryesore dhe nëse është e nevojshme edhe me pedagogët përkatës.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 32.3 Raport mbi vëzhgimin e pa paralajmëruar të cilësisë në metodat e mesimdhënies.pdf</i> <i>Evidenca 30.1 Format raportit me komente vlerësimi Pedagogu.pdf</i> <i>Evidenca 32.5 Vlerësimi i cilësisë Pyetsori i studentëve.pdf</i> <i>Evidenca 32.4 Si zbatohen në praktike syllabuset e lendeve.pdf</i></p>								
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>GVJ konstaton se NJBSC në përputhje Manualin dhe Strategjinë e saj i dërgon raportet në rektorat, dhe më pas ato dërgohen në njësitë kryesore dhe njësitë bazë ku vijohet me planin e masave për të përmbushur rekomandimet e bëra.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 32 Manuali NJSBC.pdf</i> <i>Evidenca 32.1 Strategjia e NJBSC.pdf</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="627 1317 786 1384">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="786 1317 1010 1384">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1010 1317 1233 1384">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1233 1317 1444 1384">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="627 1384 786 1429"></td> <td data-bbox="786 1384 1010 1429"></td> <td data-bbox="1010 1384 1233 1429"></td> <td data-bbox="1233 1384 1444 1429" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>GVJ konstaton se NJBSC vepron në rang institucional dhe kryen në mënyrë periodike vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit në të gjitha nivelet. Gjatë vitit akademik NJBSC realizon vlerësime çdo semestër duke e bazuar kryesisht raportimin në analizën e pyetësorëve të studentëve për procesin mësimor apo edhe konkluzionet e nxjerra nga vëzhgimet e pa paralajmëruara të cilësisë së mësimdhënies. Këto raporte janë pjesë e RVB edhe për akreditimin e</p>


<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të studimit.</p>	<p>programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, që po trajtohet në këtë raport.</p> <p>NJBSC përdor instrumenta të ndryshëm për vlerësimin e cilësisë së programit dhe mbarëvajtjes së tij, instrumenta të drejtpërdrejta ose të tërthorta të cilat i cilësuam në Standardin VI.2 Kriteri 4.</p> <p>NJSBC realizon vlerësimin e programit dhe syllabuse në lidhje me objektivat, përputhshmërinë e tyre me përmbajtjen e lëndëve, shpërndarjen e ngarkesës së orëve gjatë vitit akademik, vlerësimin e materialeve didaktive, etj. Gjithashtu një tjetër instrument është analizimi i vlerësimit që bëjnë kolegët për njëri-tjetrin apo i vlerësimit të pedagogëve nga eprori. Instrumenta të tjera janë edhe monitorime të drejtpërdrejta gjatë procesit të mësimin, vlerësimi i kontrollit të provimeve, kontrolli i procesverbaleve, etj.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Evidenca:</p> <p><i>Evidenca 32.3 Raport mbi vëzhgimin e pa paralajmëruar të cilësisë në metodat e mesimdhënies.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 30.1 Format raporti me komente vlerësimi Pedagogu.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 32.5 Vlerësimi i cilësisë Pyetsori i studentëve.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 32.4 Si zbatohen në praktike syllabuset e lëndëve.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 30 Format raporti vlerësimi Pedagogu.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 31 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 15 Analizë e Departamentit përgjegjës për programin e studimit.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Në lidhje me intervistat apo sondazhet me alumni apo edhe palët e tjera që përfshihen në realizimin e këtij programi, GVJ nuk ka gjetur ndonjë evidencë dhe as në RVB nuk cilësohet një gjë e tillë. Megjithatë gjatë vizitës në institucion GVJ u informua që institucioni gjithmonë është i hapur në sugjerimet e partnerëve me të cilët bashkëpunon sidomos ato që lidhen me tregun e punës, për të përmirësuar kurrikulat e tij si dhe gjithë procesin mësimor në tërësi. Në këtë drejtim një rol të rëndësishëm luan edhe Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</p>	
<p>Kriteret</p> <p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p> <p>Në bazë të Statutit të UL Neni 73, vendimit mbi ngritjen e NJBSC, si dhe për të pasur një përfshirje sa më të gjërë të të gjithë aktorëve, në strukturën e NJSBC janë përfshirë pesë anëtarë, nga të cilët tre përfaqësues të njëjësive kryesore, një përfaqësues i këshillit të studentëve si dhe një ekspert i jashtëm. Përveç kësaj, në takimin me anëtarët e NJBSC si dhe në përputhje me Manualin e Sigurimit të</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Brendshëm të Cilësisë, GVJ konstaton se institucioni ka garantuar përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në strukturat e ngritura për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programeve të veta të studimit. Në sigurimin dhe rritjen e vazhdueshme të cilësisë në aspektin institucional janë të përfshira të gjitha palët e interesuara: lidhshipi i universitetit, stafi akademik, studentet, stafi administrativ. Për çdo fakultet, në përputhje me Nenin 5 të Manualit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ngrihen GVB me përfaqësues zv. Dekanin, staf akademik dhe studentë të programeve bachelor dhe master të atij fakulteti. Funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e anëtarëve të NJBSC janë të përcaktuara qartë në Manualin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë Neni 3.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 6 Statuti Universiteti Luarasi.pdf</i> <i>Evidenca 32.2 Vendim mbi ngritjen e NJSBC.pdf</i> <i>Evidenca 32 Manuali NJSBC.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Ashtur sikurse u cilësua në edhe në kriteret më sipër të këtij standardi si dhe bazuar tek dokumentacioni i shqyrtuar, GVJ konstaton se Universiteti Luarasi ka garantuar përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në strukturat e ngritura për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programeve të veta të studimit. Në bazë të informacioneve të marra gjatë takimit me Dekanin e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, anëtarët e NJBSC si dhe Manualit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë Neni 1, përgjegjësit kryesorë për cilësinë në nivel institucional janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Senati i universitetit • Rektori • NJBSC • GVB në çdo fakultet • Dekanët • Staf i akademik, administrativ, studentët dhe palët e interesuara. <p>Evidenca: <i>Evidenca 32 Manuali NJSBC.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sikurse e kemi cilësuar edhe në Standardin VI.2 gjatë proceseve të vlerësimit të brendshëm nga njësitë përkatëse të ngritura për këtë proces, për çdo aspekt që lidhet me mbarëvajtjen e programeve të studimit, respektohet integriteti akademik dhe shmangët çdo diskriminim. Specifikisht në lidhje me përpunimin e të dhënave nga pyetësorët e studentëve dhe nxjerrjen e rezultateve të vlerësimit të procesit të mësimdhënies, ato i bëhen me dije çdo pedagogu në mënyrë konfidenciale. Kjo praktikë u konfirmua nga GVJ edhe nga anëtarët e stafit akademik gjatë vizitës në institucion.</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>GVJ mbështetur në vendimin mbi ngritjen e NJBSC konstaton se përfshirja e ekspertëve të jashtëm në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë është e garantuar në përbërjen e NJBSC, në përputhje me kërkesat ligjore. Në lidhje me këtë kriter për vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë, në RBV nuk raportohet ndonjë përfshirje konkrete e bashkëpunëtorëve apo aktorëve të tjerë të jashtëm të përfshirë në programet e studimit që ofrohen nga institucioni. Megjithatë sikurse është cilësuar edhe më herët në këtë raport, gjatë vizitës në institucion GVJ u informua që institucioni gjithmonë është i</p>

	<p>hapur në sugjerimet e partnerëve me të cilët bashkëpunon sidomos ato që lidhen me tregun e punës, për të përmirësuar kurrikulat e tij si dhe gjithë procesin mësimor në tërësi. GVJ sugjeron që të ketë një një pjesmarrje më konkrete dhe të raportuar jo vetëm të anëtarit të NJBSC që është ekspert i jashtëm, por edhe të aktorëve të tjerë në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p>Evidenca: Evidenca 32.2 Vendim mbi ngritjen e NJSBC.pdf</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Në takimet me Dekanin e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, pedagogët, studentët, si dhe stafin administrativ të njëjësive të ndryshme, GVJ u informua se NJBSC i bën transparente dhe i vë në dispozicion të të gjithë pjestarëve politikatat, strategjitë dhe veprimtaritë e tjera në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Sipas RVB kjo njësi vepron sipas një plani kalendarik të përvitshëm. Megjithatë GVJ nuk ka hasur një dokument të tillë, si dhe konstaton se ka një mungesë të informacioneve që lidhen me aktivitetin e NJBSC në faqen zyrtare të web-it të Universitetit Luarasi. GVJ sugjeron publikimin e të gjithë dokumentave që lidhen me veprimtarinë e NJSBC në mënyrë që të gjithë të interesuarit të njihen me të. Përsa i përket shpërndarjes në të gjitha nivelet brenda institucionit, të rezultateve të vlerësimeve të programeve të studimit që NJSBC realizon, GVJ konstaton se publikimi i të gjitha dokumentave dhe informacioneve bëhet duke respektuar, lirinë dhe etikën akademike si dhe legjislacionin për të dhënat personale.
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Në takim me anëtarët e NJBSC, GVJ u informua që kjo njësi duke vepruar në përputhje me Manualin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë Neni 3 harton Raportin Vjetor të Vetëvlerësimit. Ajo udhëzon njësitë bazë dhe kryesore lidhur me pikat e forta dhe dobësitë që kanë evidentuar. Në raport jepen sugjerime për përmirësimin e veprimtarisë së institucionit. Propozimet e NJBSC shqyrtohen nga organet dhe autoritetet drejtuese të institucionit dhe reflektohen në vendimarrje konkrete. GVJ u njoh me raportet e NJBSC nëpërmjet dokumentave të dorzuara në DVV. Duke u mbështetur tek raportet e hartuara dhe sugjerimet e NJBSC, institucioni ka ndërmarrë një sërë masash në kuadër të përmirësimit të cilësisë në tërësi. Këtu mund të përmendim zhvillimin e trajnimeve të ndryshme që janë zhvilluar me stafin akademik për të përmirësuar metodat e mësimdhënies.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	
	Evidenca: Evidenca 32.3 Raport mbi vëzhgimin e pa paralajmëruar të cilësisë në metodat e mesimdhënies.pdf



	<p><i>Evidenca 32.4 Si zbatohen ne praktike syllabuset e lendeve.pdf</i> <i>Evidenca 32.5 Vleresimi i cilesise Pyetsori i studenteve.pdf</i> <i>Evidenca 32 Manuali NJSBC.pdf</i> <i>Modul trajnimi "Learning assessment and student motivation".pdf</i> <i>Moduli i trajnimit - Mësimdhënia me në qendër studentin.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ u informua se Universiteti Luarasi ka si mision të krijojë dhe të zhvillojë dije të qëndrueshme përmes mësimdhënies e mësimnxënies cilësore, integritit me praktikën, nxitjes së kurajës dhe kërkimit shkencor për formimin e profesionistëve elitare e me etikë të lartë profesionale. Në këtë kuadër sigurimi i cilësisë është në fokusin e tyre. Në takimin me Dekanin e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit si dhe Përgjegjësin e Departamentit të Informatikës Ekonomike GVJ u informua se ata organizojnë vazhdimisht takime me personelin dhe studentët për ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me rritjen e cilësisë së procesit mësimor në tërësi.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Informatikë Ekonomike" të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti "Luarasi"

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Mbështetja e Grupit të Biznesit ku bën pjesë Kolegji Universitar "Luarasi" gjë që lehtëson kryerjen e praktikave profesionale për studentët, rritjen e vizibilitetit dhe përmirësimin e imazhit të Institucionit përmes kompanive media të grupit, si edhe pasurimin e jetës akademike me evente dhe ngjarje të tilla si prezantime, forume diskutimi, etj.
2. Lokacioni i kampusit është një avantazh i Institucionit duke qenë lehtësisht i aksesueshëm për studentët dhe stafin si për shërbime akademike apo edhe ato ekstra kurrikulare.
3. Staf i pedagogjik i Institucionit paraqitet i kompletuar dhe me formim të plotë dhe cilësor në lëndët e përgjithshme dhe në lëndët e profesionit specifik të programit të studimit.
4. Plani mësimor i programit të studimit është i kompletuar me lëndët e rëndësishme dhe prioritare të fushës duke mundësuar një formim cilësor për studentët në këtë program.

Pika të dobta:

1. Në Planin mësimor të Programit të Studimit bie në sy mungesa e larmisë së lëndëve me zgjedhje që do t'u jepte më shumë fleksibilitet studentëve të programit dhe do t'u jepte mundësi të zgjerimit formimit të tyre në fusha ku ata kanë prirje individuale apo ku shohin më shumë perspektivë dhe interes për të ardhmen. **(Standardi II.4)**
2. Në bibliotekë vërehet një mungesë e titujve të librave të literaturës bazë të detyruar sidomos në gjuhën shqipe, për të mbështetur nevojat e programit Bachelor në Informatikë Ekonomike, si dhe të abonimeve në bibliotekat online të mirënjohura ndërkombëtare. Gjithashtu vërehet një mungesë e planit të detajuar të shtimit të zërave të bibliotekës në bazë të kërkesave të njësive bazë apo kryesore. **(Standardi IV.4)**
3. Pavarësisht se veprimtaria e NJBSC është e evidente në institucion, bie në sy mungesa e një plani kalendarik të përvitshëm dhe pasqyrimi i këtyre aktiviteteve në faqen e web-it të institucionit. **(Standardi VI.4, Standardi VI.5)**


Rekomandime:

1. Pasurimi i Planit mësimor me lëndë me zgjedhje cka do të shtonte gamën e mundësive për studentët dhe do të rinovonte fondin e njohurive që ofron programi i studimit.
2. Pasurimi i fondit të librave fizikë në bibliotekë, për literaturën bazë të detyruar sidomos në gjuhën shqipe, shtimi i abonimeve për bibliotekat online, si dhe hartimi i një plani të detajuar vjetor për shtimin e literaturës që lidhet me këtë program studimi, apo përditësimin e literaturës ekzistuese me botime të 5 viteve të fundit.
3. Hartimi i një plani kalendarik të përvitshëm i aktiviteteve të NJBSC dhe publikimi i të gjithë dokumentave që lidhen me veprimtarinë e NJSBC në mënyrë që të gjithë të interesuarit të njihen me të.

Conclusions of the Evaluation Process of the study program “Bachelor in Business Informatics” of the Higher Education Institution “Luarasi” University

Strengths and affirmations

1. Support from the Business Group (KUL is one of the many entities of this group) which facilitates the implementation of professional internships for students, enhances the visibility and improves the image of the Institution through the media branch of the group, as well as enriches the academic life with events such as presentations, discussion forums, etc.
2. The location of the campus is an advantage to the Institution, being easily accessible both to the students and the staff so they can easily perform their academic and extra-curricular activities.




3. The background and CVs of the staff of the Institution appear to be comprehensive and qualitative and enable a qualitative teaching process for the Study Programme regarding the disciplines that are peculiar to the programme.
4. The curriculum of the study program is complete with the important and priority subjects of the field, enabling a qualitative education for the students in this study program.

Weaknesses:

1. In the Curriculum of the Study Program, it is noticeable the lack of variety of elective subjects/courses that would give more flexibility to the students of the program and would offer to them the opportunity to expand their knowledge in areas that they find more interesting or where they see more perspective and interest for the future. **(Standard II.4)**
2. There is a lack of book titles of compulsory literature in the library, especially in the Albanian language, to support the needs of this study program, as well as subscriptions to well-known international online libraries. There is also an absence of a detailed plan for the addition of library titles, to fulfill the needs of departments and faculties. **(Standard IV.4)**
3. Even though the activity of IQAU is evident in the institution, the lack of an annual calendar plan and the reflection of these activities on the institution's website is noticeable. **(Standard VI.4, Standard VI.5)**

Recommendations:

1. Enriching the Curriculum with elective subjects / courses (within the allowed local legislative limitations), which would increase the range of opportunities for students and increase the offer by the study program.
2. Enriching the fund of physical books in the library, for compulsory literature especially in the Albanian language, adding subscriptions to online libraries, as well as drawing up a detailed annual plan for the enrichment of literature related to this study program, or updating of the existing literature with publications of the last 5 years.
3. Drawing up an annual plan of IQAU activities and publishing all documents related to IQAU activities on the website of the institution, to be public and transparent.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X